

CENTRE FOR CO-OPERATION WITH NON-MEMBERS
CENTRE POUR LA COOPERATION AVEC LES NON-MEMBRES

ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE ZHVILLIM

**POLITIKAT ARSIMORE
PËR NXËNËSIT NË RREZIK
DHE ATA ME PAAFTËSI
NË EVROPËN JUG-LINDORE**

KOSOVË



ORGANISATION DE COOPÉRATION
ET DE DÉVELOPPEMENT ÉCONOMIQUES

ORGANISATION FOR ECONOMIC
CO-OPERATION AND DEVELOPMENT

ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE ZHVILLIM

POLITIKAT ARSIMORE PËR NXËNËSIT NË RREZIK DHE ATA ME PAAFTËSI NË EVROPËN JUG-LINDORE

KOSOVË

Publikuar fillimisht nga OECD ne gjuhën angleze nën titullin: *Synthesis report and Chapter 5 Kosovo in Education Policies for Students at Risk and those with disabilities in South Eastern Europe: Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Kosovo, FYR of Macedonia, Moldova, Montenegro, Romania and Serbia.*

©2007 Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Paris.

©2007 Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Paris për këtë version Shqip.

OECD nuk është përgjegjëse për kualitetin e botimit në Shqip përfshirë lidhjen me tekstin origjinal. Në rast të ndonjë mospërputhje, origjinali në Gjuhën Angleze do të vendosë.

PARATHËNIE

Ky raport mbi situatën e zhvillimit të arsimit për nxënësit në rrezik dhe atyre me paaftësi në Kosovë është përgatitur nga Qendra për Bashkëpunim me Ekonomi Jo-Anëtarëshe (CCNM) dhe nga Qendra për Kërkime Arsimore dhe Risi (CERI) e OECD-së. Raporti është i shoqëruar nga një raport sintetik duke krahasuar situatën e tanishme të arsimit special në nëntë sisteme arsimore të Evropës Jug Lindore. Të dy raportet janë pjesë e publikimit të OECD-së, i cili ishte publikuar në vitin 2006 në gjuhën Angleze dhe Frengje nën të njëjtin titull, duke mbuluar sistemet arsimore në Bosne dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, IRJ të Maqedonisë, Moldavinë, Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë.

Ky publikim i kontribuon angazhimit të OECD-së të përgjithësojë qëllimet dhe strategjitë e Iniciativës së Reformës Arsimore të Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug Lindore duke marrë materiale të situatës së tanishme dhe duke kontribuar në identifikimin dhe implementimin e politikave arsimore të ministrive të arsimit në këtë rajon.

Raporti i vendit, duke qenë një nga gurrthemelet e projektit “Zhvillimet e Arsimit për Nxënësit në Rrezik dhe atyre me Paaftësi në Evropën Jug Lindore”, shërbenë jo vetëm si pikë referimi por poashtu edhe si inkurajim për veprime të mëtejshme në këtë fushë. Duke i përcjellur këto përfundime, një numër i seminareve dhe aktiviteteve të afërta janë organizuar dhe do të organizohen për personat kyç: zyrtarët e ministrisë, ekspertët, mësimmshënësit dhe zyrtarët e statistikës. Veç kësaj synohet t’i shpërndahen përfundimet e këtyre raporteve audiencës më të gjërë të mundshme duke inkurajuar në këtë mënyrë përpjekjet e ndryshme në vetë Kosovën.

Ky aktivitet i OECD-së është bërë i mundur prej granteve nga Finlanda, Norvegjia, Komuniteti Flemish i Belgjikës dhe Banka Botërore. Mbështetje shtesë është siguruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Austrisë dhe Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug Lindore

Raporti i vendit është bazuar në punën e Feride Aliut dhe Enver Mekollit.

Koordinim i përgjithshëm dhe përkrahje është siguruar nga Peter Evans, Christine Stromberger, Gerhard Kowar dhe Ian Whitman, me përkrahje teknike nga Conor Breen dhe Ginette Mériot nga Sekretariati i OECD-së.

Barbara Ischinger

Drejtoreshë e Arsimit

KAPITULLI 5 – KOSOVA

Raporti kombëtar mbi “Politikat e Arsimit për nxënësit në rrezik dhe atyre me paaftësi” i Kosovës përshkruan statusin aktual të arsimit me nevoja të veçanta dhe atij gjithëpërfshirës si dhe përpjekjet për reforma të cilat janë në zbatim. Ndihmë e çmuar është ofruar nga Mbështetja Finlandeze Zhvillimit të Sektorit të Arsimit (FSDEK) dhe masa të ndryshme për të vendosur arsimin gjithëpërfshirës janë marrë që nga viti 2002. Sidoqoftë, politikat dhe korniza ligjore sikurse edhe kornizat institucionale dhe administrative nevojitet të zhvillohen më tej. Sikurse që është rasti me të gjitha raportet tjera të prezantuara në këtë libër, ky raport mbulon seksionet në vazhdim: një pasqyrë të shkurtër të sistemit arsimor që u paraprinë kapitujve që përshkruajnë politikat e kornizës ligjore duke u fokusuar në grupet speciale, statistikave dhe indikatorët, dhe situatën aktuale të trajnimit të mësimitdhënësve, pedagogjinë, planprogramin dhe organizimin e shollës. Koncepti i integritetit dhe përfshirjes janë çështje kryesore të vëmendjeje i është kushtuar barrierave dhe problemeve të përfshirjes dhe barazisë në arsim, pjesëmarrjes së prindërve dhe shërbimeve tjera mbështetëse. Raporti gjithashtu i referohet gjithësisht *Planit Strategjik për Arsimin e Fëmijëve me nevoja të veçanta* në Kosovë, dokumenti i përgatitur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2003, i cili përshkruan strategjitë e reja dhe zhvillimin e politikave.

HYRJE

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova mbeti nën administrimin e ish-Jugosllavisë, edhe pse popullata në tërësi preferonte ndarjen ose pavarësinë. Gjatë vitetve të pasluftës në Kosovë politika e drejtuar nga Beogradi la shumicën më të madhe të popullatës të pashkollë¹. Kosova kishte vetëm 57 120 nxënës dhe nga 777 mësimdhënës vetëm disa ishin Kosovarë. Disa të drejta më të mëdha arsimore janë dhënë gjatë dekadave të ardhshme dhe në vitin 1970 u themelua universiteti i parë në Kosovë. Me 1980, sistemi arsimor i Kosovës kishte 358 251 nxënës dhe 17 751 mësimdhënës dhe punëtorë tjerë të arsimit. Megjithatë, në vitin 1989 qeveria e Serbisë vendosi regjimin ushtarak në Kosovë dhe sistemi arsimor ishte shtypur. Popullata e Kosovës krijoi opozitë politike – duke vendosur strukturë paralele për arsimin nën Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës në Imigrim, (tani Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Lidhjes së Arsimitarëve të Kosovës. Kjo histori e vështirë e sistemit arsimor u ndikua gjithashtu nga konflikti në vitet e fundit në Kosovë, gjatë të cilit shumica e popullatës ishte e zhvendosur nga brenda. Kjo i bëri mundësitë për arsimin edhe më të vështira për t'u realizuar.

Sot, sistemi arsimor përfshinë më shumë se 424 000 nxënës dhe 26 000 mësimdhënës dhe tentimet për reforma kanë filluar. Megjithatë, sistemi paralel arsimor, që ndau Shqiptarët e Kosovës nga Serbët e Kosovës në vitet 1990-1998, kërkon përpjekje të theksuar për të ndryshuar. Përveç kësaj, cilësia arsimore mbeti pa kontakt për më shumë se 10 vite, me zhvillimet në teorinë dhe praktikën e arsimit Perëndimor. Statusi i paqartë politik i Kosovës dhe faktorët historik, ekonomik dhe faktorë të tjerë nuk do të tejkalohen lehtë në procesin e reformave.

Sistemi i arsimit special

Personat e paaftë të Kosovës – llogaritur në rreth 150 000 – shpesh jetojnë në rrethana të vështira, në varfëri dhe izolim dhe me njollë shoqërore të ngjitur për gjendjen e tyre. Sistemi arsimor në periudhën e pas-Luftës II Botërore kishte katër shkolla speciale për fëmijët e moshës së shkollës fillore dhe të mesme. Megjithatë, fëmijet me dëmtime nuk e kishin mundësinë e pranimit të arsimit cilësor siç ne mendojmë për të sot. Kapacitetet e limituara të regjistrimit të shkollave speciale, sidomos në zonat rurale, e ka bërë përfshirjen e shumicës së fëmijëve me nevoja të veçanta të pamundur. Prindërit nuk ishin në gjendje të merrnin pjesë në jetërat e fëmijëve të tyre nëse ata shkonin në shkollë, pasi që shkollat shpesh ishin të izoluara. Prandaj sistemi i arsimit special zhvilloi më tej një model të veçantë, ku mësimdhënësit ose specialistë të tjerë klasifikonin nxënësit në bazë të paaftësive të tyre. Megjithatë, nganjëherë edhe fëmijët me dëmtime të vogla janë lënë krejtësisht jashtë sistemit arsimor. Ata ande ishin të konsideruar tepër “të dëmtuar” për shkollë. Si pasojë, kishte një shkallë shumë të vogël të fëmijëve me ndonjë të metë në sistemin arsimor. Sot, shumica e fëmijëve me të meta (më shumë se 80%) ende nuk kanë qasje në mësimdhënje të përshtatshme në programet arsimore. Ata që mësojnë ngadalë ose fëmijët në regjionet rurale janë lënë jashtë shkollës gjithashtu.

Qeverisja e sistemit arsimor në Kosovë tani është e ndarë në katër nivele: qendror, regjional, komunal dhe nivelin shkollor. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në nivelin qendror përfshinë përgjegjësitë e zhvillimit të legjislacionit, përcaktimin se cilat shkolla duhet të funksionojnë si

¹ Plani Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë, 2002-2007, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Janar 2003.

qendra burimore dhe vendosjen për misionin e këtyre qendrave burimore. MASHT ka një politikë që të avancojë arsimimin e personave me nevoja speciale përfshirë përmes arsimit gjithëpërfshirës dhe përmes Njësisë së Arsimit Special. MASHT duhet gjithashtu t'i përshtatë përshkrimet e vendeve të punës së mësimdhënësve, përfshirë ata që janë duke punuar me programin e lëvizshëm të arsimit special, të vendosë për nevoja të personelit tjetër dhe të sigurojë zhvillimin e kompetencave të personelit dhe mbulim të përshtatshëm gjeografik të qendrave burimore dhe të udhëtojë nëpër tërë regjionet e Kosovës për të kontrolluar cilësinë e përpjekjeve të arsimit special. MASHT ka caktuar disa donatorë ndërkombëtarë që të jenë agjensione drejtuese për projekte të lidhura me komponente të ndryshme të sistemit arsimor. Për arsimin special agjension drejtues është programi i qeverisë Finlandeze "Mbështetja Finlandeze Zhvillimit të Sektorit të arsimit (FSDEK)". Ata kanë detyrën e zhvillimit të kapaciteteve lokale në arsimin special dhe të furnizojnë mbështetjen e projektit dhe rezultatet e tij. Në Kosovë, ka një dëshirë të fortë për të siguruar arsimim më të mirë për të gjithë në partneritet me donatorët ndërkombëtarë për të plotësuar standardet Evropiane dhe botërore.

KORNIZA LIGJORE

Korniza kushtetuese për qeverinë e përkohshme, lëshuar nga Përfaqësuesi Gjeneral i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara me 15 Maj 2001, ka themeluar një sistem qeverisës në Kosovë që përfshinë respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe kundërshtimin e çdo lloj diskriminimi. Edhe pse paafërsija nuk është përmendur në mënyrë specifike, korniza kushtetuese në Kosovë zyrtarisht implementon nenet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut dhe dokumenteve tjera. Qeveria e Kosovës poashtu ka nënshkruar Konventën ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Pavarësisht nga padisponueshmëria e fondeve për t'iu mundësuar beneficione financiare dhe të tjera fëmijëve me nevoja të veçanta, këtu nuk ka mungesë të qëllimeve të mira. Qeveria dhe parlamenti mund të aprovonjë ligje mbi të drejtat e personave me nevoja të veçanta së bashku me planet për veprim që do të përmirësojë kushtet me kohë. Këto ligje duhet të përmbajnë të drejtat për shëndet dhe rehabilitim dhe mbështetje të tjera që iu mundëson fëmijëve me nevoja të veçanta të marrin pjesë plotësisht në jetën në komunitet.

MASHT ka zhvilluar një kornizë ligjore për reformat arsimore, duke prezantuar *Ligjin e ri për Arsimin Fillor dhe të Mesëm (2002)* dhe duke lëshuar udhëzime administrative për të rregulluar funksionimin e institucioneve arsimore, përfshirë veprimet për të ofruar arsimim më të mirë për të gjithë. Këto përpjekje do ta çojnë MASHT-in nga faza preliminare e reformave në fazën tjetër të zhvillimit praktik dhe implementimin e sistemit të ri arsimor në Kosovë. Në vitin akademik 2000/2001, janë bërë përgatitje për infrastrukturë ligjore dhe profesionale për të implementuar sisteme të reja të arsimit të përgjithshëm, profesional dhe të lartë. Një strukturë e re arsimore ishte vendosur, përfshirë vendimet për standardet e arsimit dhe zhvillimin e plan-programit mësimor gjeneral të arsimit.

Në *Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm*, rekomandohet që MASHT të zhvillojë një politikë për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta që do të mbulojë vitet deri në fund të vitit 2007. Kjo politikë duhet të përcaktojë të drejtat për arsimin special, procedurat administrative për vendime në arsimin special, një procedurë për vlerësimin e ekspertëve, plan-programin dhe pedagogjinë mësimore, shërbime këshilluese dhe shëndetësore për fëmijët me nevoja të veçanta, mësimin e gjuhës së shenjave dhe sistemit të Brailit, kategorizimin e punëtorëve (mësimdhënës, kujdestarë të fëmijëve dhe kujdestarë të ditës), trajnime të sponsoruara nga ministria, buxhet të përbashkët komunal dhe rrogave dhe procese për mbledhjen e fondeve për të renovuar infrastrukturën shkollore. Vec kësaj, një plan strategjik është zhvilluar i cili është prezantuar më poshtë.

PASQYRË E POLITIKËS FOKUSUAR NË GRUPET SPECIALE

Sipas *Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm* “e drejta për arsim u është siguruar të gjithë fëmijëve”. Prandaj, të gjithë fëmijët, përfshirë ata që kanë dëmtime dhe vështirësi në mësim kanë të drejtë të shkojnë në shkollë. Fëmijët me dëmtime në të dëgjuar dhe të parë, me çrregullime emocionale dhe në sjellje, fëmijët të cilët kanë vështirësi të mësojnë ose në komunikim dhe gjuhë duhet gjithashtu të përfshihen në shkolla, ndonëse ata nuk mundën gjithmonë të arrijnë të njëjtat objektiva sikur nxënësit tjerë.

Në vitin 1999, shumë probleme të mëdha ishin identifikuar të cilat theksuan nevojën për ndryshime në sistemin e arsimit special. Njëra ishte nevoja për të bashkuar strukturat paralele shkollore. Vështirësi të tjera lidhur me funksionimin e shkollës përfshinin mungesën e lëndëve të drejtimeve të mjaftueshme, një shkallë jo të kënaqshme të arritjes (posaçërisht në arsimin parashkollor dhe atë të mesëm dhe plan-program të vjetëruar të mësimdhënësve-trajnimeve që nuk nxisin cilësinë në procesin e mësimdhënies. Mësimdhënësit në shkollat speciale nuk janë trajnuar për mësimdhënie sipas metodave më të reja, specifike për lloj të paaftësisë (përfshirë mësimin e nxënësve të verbër dhe atyre me dëmtime në të dëgjuar). Shkollat kanë infrastrukturë të dobët dhe materiale shkollore të dobëta në aspektin sasior dhe cilësorë (*p.sh.* shkollat dhe klasët, tavolinat dhe karrigat si dhe paisjet audio-vizuele, tekstet shkollore, material mësimdhënës dhe ndihmë në të dëgjuar). Kosova nuk ka shumë interpretues në gjuhën e shenjave të zhvilluar së voni. Diagnostifikimi dhe klasifikimi i fëmijëve implementohet pamjaftueshëm, pjesërisht për shkak të mungesës së ekspertëve. Transporti shpesh nuk është në disponim, madje edhe për fëmijët që kanë dëmtime të rënda. Nxënësit me nevoja speciale rrallë janë të përfshirë në procesin e arsimit dhe buxhetet e limituara nuk lejojnë implementimin e suksesshëm të reformave të arsimit special. Veç kësaj, nuk ka ndonjë politikë të qeverisë për arsimin special, e as nuk ka insitucione kërkuese për çështjet e lidhura me arsimin për persona me nevoja të veçanta. Më në fund, komuniteti ka mungesë të informimit për çështje të arsimit special dhe shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik rezulton në shume vështirësi të tjera.

Të gjitha këto probleme dhe vështirësi janë konvertuar në objektiva të MASHT-it në planin zhvillimor pesë-vjeçar, pjesërisht të përshkruar në pjesën e katërt të planit strategjik më poshtë. Të arriturat në këtë reformë do të varen gjithashtu nga përpjekjet e organizatave tjera të qeverisë së Kosovës. Lëvizja drejt perspektivës së fokusuar në fëmijë për fëmijët me nevoja të veçanta do të kërkojë përfshirjen e Ministrisë së Shërbimeve Shëndetësore, Ministrisë së Punës Sociale, organizatave lokale dhe ndërkombëtare relevante, prindërve, institucioneve më të larta arsimore, mediave dhe të tjerëve. Ndonëse gjithmonë disa fëmijë mund të mbesin përgjithmonë jashtë sistemit shkollor për shkak të vështirësive në kapërcimin e dëmtimeve të ndryshme dhe paaftësisë në mësim, krijimi i qeverisë së Kosovës dhe MASHT-it ka ndihmuar në avancimin e arsimit special. Njësia e arsimit special të MASHT-it gjithashtu ka kompletuar një plan për krijimin e klasëve të bashkangjitura në të gjitha regjionet e Kosovës, të cilat do të funksionojnë në shkolla të rregullta.

Definicionet dhe kategorizimi i personave me nevoja të veçanta

MASHT, në bashkëpunim me Mbështetjen Finlandeze për Zhvillim të Sektorit të Arsimit (FSDEK) dhe disa pjesëmarrës nga organizatat e personave me paaftësi, ka përgatitur fjalorin terminologjik lidhur me definimin e “personave me aftësi të kufizuara”. Fëmijët me vonesa në zhvillim ose dëmtime në të dëgjuar, folur, parë ose dëmtime fizike apo me çrregullime emocionale ose të sjelljes janë të gjithë të konsideruar persona me nevoja të veçanta. Ky definim i fëmijëve me nevoja të veçanta i bën të përshtatshme perspektivat e reja për aftësitë e të gjithë fëmijëve për të bërë aktivitete të ndryshme që më parë nuk ishin konsideruar të mundshme në përputhje me shkallën e tyre të kapacitetit mësues. Termi “nevoja të veçanta” është përdorur për të nënvizuar nevojat mbështetëse të nevojshme lidhur me të drejtat e tyre për kujdes dhe mbrojtje me qëllim që të sigurohet zhvillimi i tyre optimal prej lindjes deri në moshën

madhore. Në gjuhën Shqipe, termi më së shumti i përdorur për njerëz me të meta është ai që do të thotë “njerëz të dëmtuar” ose “njerëz të gjymtë”. Këta terma ende përdoren në Shqipëri. Në Kosovë, njerëzit gjithashtu thonë “fëmijë me nevoja të veçanta”. Një tjetër term që tregon një perspektivë të ndryshme është “persona me vështirësi në zhvillim”.

Kategorizimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në të ardhmen duhet të bëhet përmes një qendre diagnostifikuese ose nga një ekip specialistësh (përfshirë mjekë, neuro-psikiatër, psikologë, asistentë social dhe specialistë tjerë të fushave të ndryshme). Kjo qendër do t’u japë shkollave një profil funksional të fëmijëve, të rishikohet në intervale të rregullta, përfshirë statusin dhe kapacitetin e tyre të tanishëm, llojin dhe shkallën e dëmtimit, mundësitë zhvilluese, limitimet, anët e fuqishme dhe të dobëta dhe indikacionet për trajtim. Në këtë bazë, shkolla do të hartonte një program individual arsimor me informatat relevante për mësimdhënësin.

Arsimi gjithëpërfshirës, paralelet e bashkangjitura dhe arsimi special në Kosovë

Në Kosovë, arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është duke u realizuar në kuadër të kornizës së sistemit të arsimit gjithëpërfshirës. Përfshirja është filozofi arsimore sipas së cilës të gjithë nxënësit me paaftësi kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet arsimore, sociale, rekreative dhe profesionale të komunitetit të tyre së bashku me shokët e tyre. Kjo është një filozofi e re në Kosovë, që kërkon përpjekje të konsiderueshme për të mbështetur individët për pjesëmarrje të plotë, ndryshe nga sigurimi i shërbimeve të ndara për personat me dëmtime. Më poshtë është një pasqyrë përmbledhëse e kuptimit në Kosovë të këtyre koncepteve me komente për zhvillimet e fundit.

Arsimi gjithëpërfshirës do të thotë të ofrohet arsimim për fëmijët me nevoja të veçanta përbrenda sistemit arsimor të rregullt në klasë me fëmijët tjerë. Ky model pranon se të gjithë nxënësit kanë të njëjten të drejtë për mbështetje dhe se sistemi arsimor mund të implementojë metoda mësimore që i përbushin nevojat e të gjithë nxënësve përderisa respekton dallimet në mes të nevojave të tyre lidhur me moshën, gjininë, përkatësinë etnike, gjuhën, poziten socio-ekonomike, paaftësitë dhe karakteristikat tjera. Në luftën kundër diskriminimit, shkolla e rregullt ka një rol për të luajtur në sigurimin e arsimit për të gjithë – duke krijuar një komunitet në të cilin fëmijët me nevoja të veçanta mund të ndjehen rehatshëm. Shkolla e rregullt gjithëpërfshirëse mund të sigurojë një arsim efektiv për një numër të konsiderueshëm të nxënësve, duke zvogëluar në këtë mënyrë zgjerimin e sistemit të ndarë arsimor.

Klasët e bashkangjitura në shkollën e rregullt përfshijnë pilot projekte në implementimin e programeve të reja përfshirëse. Klasët e bashkangjitura (së paku një në secilin regjion) do të zhvillojnë modele dhe procedura të duhura për përfshirjen në të ardhmen dhe do të jenë të inkurajuar që gradualisht të transformohen në qendra burimore të cilat e mbështesin arsimin gjithëpërfshirës. Qëllimi i tyre është të avancojnë idenë e qasjes gjithëpërfshirëse, duke inkurajuar dhe asistuar zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës në aktivitetet ditore në klasë. Shkollat e rregullta me klasë të bashkangjitura janë përfituesit kryesorë të zhvillimit dhe implementimit të politikës së arsimit special në Kosovë.

Shkollat speciale mbesin pjesëmarrëse në procesin e zhvillimit dhe implementimit të politikave për arsimin gjithëpërfshirës dhe janë të vetment shkolla për momentin ku interesimi i theksuar në arsimin gjithëpërfshirës mund të shihet. Përfshirë në zhvillimet e fundit të politikës është konvertimi i këtyre shkollave në qendra të mundshme burimore për zhvillimin e mëturjeshëm të arsimit gjithëpërfshirës (një model i përdorur në shumë vende të zhvilluara, përfshirë Finlanden, është e përshtatshme për shumë më poshtë). Këto shkolla gjithashtu mund të japin mbështetje në zhvillimin e burimeve njerëzore për shkollat gjithëpërfshirëse.

Implementimi i arsimit gjithëpërfshirës: roli i qendrave burimore

Shkollat speciale gradualisht do të transformohen në qendra burimore në dy faza. Së pari, në fazën tradicionale në të cilën mësimdhënësit në shkollat speciale janë përgjegjës për integrimin e nxënësve më paaftësi në shkollat e rregullta. Detyrat e mësimdhënësit special do të ridefinoheshin për të përfshirë: mësimin në klasë apo shkollë speciale, mësimin shëtitës për fëmijët me nevoja të veçanta në regjion dhe detyra zhvilluese dhe kërkimore. Prandaj mësimdhënësit janë ende të zënë në klasët e tyre, në kontakt me procesin e përditshëm të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit mund të japin mësim në ekip, duke ia lejuar një mësimdhënësi të ketë një ditë pushimi për detyrat tjera kërkimore, përderisa mësimdhënësi tjetër mund të jap mësim. Ky model merr në konsideratë kompetencat e tanishme brenda shkollës speciale dhe do të evoluoj, përmes zhvillimit profesional dhe të sistemit, drejt një modeli më permanent të qendrës burimore.

Në modelin e dytë, shkolla është e ndarë në departmente, me disa mësimdhënës që japin mësim në qendrat burimore dhe tjerët si mësimdhënës shëtitës ose në procesin e rregullt të arsimit. Ekspertë të tjerë janë gjithashtu të përfshirë në procesin e mësimin. Një grup rehabilitues, që përbëhet prej personelit shëndetësor dhe terapistëve, është i angazhuar në kujdesin shëndetësor dhe rehabilitimin e nxënësit. Aty ka gjithashtu një njësi botuese që siguron material për mësim. Në vendet ku integrimi i nxënësve me dëmtime në të parë është implementuar, nxënësit tjerë me paaftësi që vijojnë shkollat speciale gjithashtu vijojnë procesin mësimor në shkollat lokale.

Koncepti i “qendrës burimore” është qëndror në implementimin e arsimit dhe politikës gjithëpërfshirëse përgjatë perëndimit dhe në Kosovë. Me qëllimin e themelimit të një qasjeje efektive drejt gjithëpërfshirjes, qendra burimore duhet të sigurojë që funksionet e tyre profesionale plotësojnë nevojat e veçanta të nxënësve. Qendrat burimore duhet të asistojnë në organizimin e shkollave që të plotësojnë nevojat e nxënësve me paaftësi në arsim, duke kryer vlerësime si dhe programe trajnimi shëruese dhe duke luajtur rol në sigurimin e nevojave mjekësore, shëndetësore dhe terapeutike të nxënësve. Përgatitja e modelit të mësimdhënies dhe mësimin për fëmijët me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit të rregullt është qenësore, përfshirë trajnimin gjatë punës për të gjithë mësimdhënësit e nxënësve më nevoja të veçanta.

Së bashku me prindër dhe specialistë të tjerë të programit, qendrat burimore duhet të përgatisin, monitorojnë dhe mbështesin implementimin e Planit Individual Arsimor (PIA). Kurse profesionale për nxënës, mësimdhënës, prindër, personel dhe persona tjerë në nevojë duhet gjithashtu të organizohen. Materiale për mësimdhënie duhet të zhvillohen dhe prodhohen, së bashku me material për mësim që janë të çmuara për nxënës individual. Shkollat dhe qendrat duhet të sigurojnë se janë të përgatitura mirë për të trajnuar personelin brenda qendrës burimore përmes vazhdimin të arsimit dhe ndarjes së informacioneve. Qendrat burimore gjithashtu mund të mbështesin kërkimet dhe shtojnë cilësinë e aktiviteteve brenda qendrës dhe më tej, përmes konferencave, seminareve, publikimeve dhe Internetit, si dhe përmes bashkëpunimit me fakultetin e edukimit të universitetit dhe MASHT-it. Shkollat gjithashtu duhet të ndërtojnë një rrjet të mësimdhënësve dhe profesionistëve, përfshirë grupe të mësimdhënësve, shkollave dhe kolegëve. Një rrjet special (i quajtur “Rrjeti”) duhet të themeloj ekspertizë për paaftësi jashtë shkollës, përfshirë grupet e ekspertëve për vlerësim. “Rrjeti” duhet të koordinojë trajnimet gjatë punës, të koordinojë dhe monitorojë në mënyrë aktive PIA-në, të prodhojë materiale, të zhvillojë metoda të mësimdhënies dhe të udhëheqë seminare dhe kurse trajnimi. Ato duhet gjithashtu të ndërmarrin fushata informimi, kërkime, kontrollë të cilësisë dhe zhvillim të rrjetit dhe të inkurajojnë aktivitete shtesë të planprogramit si dhe të stimulojnë grupin. Rrjeti duhet të shpërndaj informata dhe asistojë në përgjithësi në përmirësimin e nivelit të arsimit special në Kosovë. Më në fund, përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, shkollat dhe qendrat duhet të mbahen në një hap me nivelet lokale, nacionale dhe ndërkombëtare me qëllim që të zhvillohet më tej me vendet fqinje.

Modelet e qendrave burimore të prezantuara këtu ilustronë se si mjetet për konstruktimin dhe funksionimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë mund të funksionojnë. Arsimi gjithëpërfshirës pa përdorimin e qendrave burimore krijon shqetësime për komunitetin që tashmë mund të jenë të mbingarkuara me përgjegjësi. Në shumë vende (si Danimarka dhe Norvegjia), ekipi qëndror burimor shfrytëzon në mënyrë të larmishme kompetencat që janë të fokusuar brenda qendrës për të rritur kapacitetet e mësimdhënësve dhe personelit. Përmes Internetit dhe departamenteve të ndryshme (mjekësor, psikologjik, terapeutik, etj.) qendrat burimore kanë zgjeruar bazat e tyre për të mbuluar të gjitha nevojat e nxënësve. Sipas ligjit mbi arsimin, MASHT duhet të zhvillojë plane dhe hapësira për arsimin special. MASHT mund të asistojë në themelimin e qendrave burimore në Kosovë duke nxjerrë politika qeveritare mbi atë se si këto qendra do të jenë të organizuara.

Rolet e qendrës burimore: modeli Finlandez nga një shkollë në Juvaskal për fëmijët më dëmtime në të parë

Mësimdhënia dhe kërkimi: Mësimdhënësit duhet të organizojnë kurse për nxënësit në qendrën burimore, të përpilojnë materiale për mësimdhënie dhe të përgatisin PIA për të gjithë pjesëmarrësit. Mësimdhënësit duhet të bashkëpunojnë me edukatorë dhe ekspertë të tjerë në implementimin e kursit, të marrin pjesë në planifikimin e tranzicioneve të nxënësve dhe në udhëheqjen (drejtimin) e karrierës për nxënësit dhe të përgatisë një vlerësim dhe raporte tjera në shkollën e rregullt dhe për prindër. Mësimdhënësit duhet t'i vlerësojnë nevojat, të marrin pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e materialeve dhe, nëse duhet, të sigurojnë mbështetje speciale gjatë testeve. Mësimdhënësit gjithashtu duhet të formojnë burime informative për mësimdhënësit në shkollat gjithëpërfshirëse përmes zhvillimit dhe prodhimit të materialit mësimor për mësim nga distanca, vizita për mësimdhënësit e shkollave gjithëpërfshirëse në qendrat burimore dhe të planifikojnë dhe shfrytëzojnë kurset (p.sh. mësim i vazhdueshëm për nxënësit e rritur).

Bashkëpunimi, rrjetëzimi dhe ndarja e informatës: Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë duhet të zë vend brenda qendrave burimore dhe përgjatë shkollave të nxënësve dhe komunave. Bashkëpunimi me autoritetet shkollore, autoritetet e mirëqenies sociale dhe spitaleve duhet të bëhet rregullisht. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi me shkollat tjera speciale, qendrat burimore dhe OJQ-të, administratorët e shkollave, atyre që sigurojnë mjete mbështetëse, spitalet dhe shërbimet tjera duhet të përfshihet. Pjesëmarrja në arsimin lokal, përpjekjen lokale dhe ndërkombëtare të ndarjes së informatës në arsimin special është qenësore. Aktivitetet tjera mund të përfshijnë pjesëmarrjen në kurse dhe konferenca si specialist dhe pjesëmarrja në aktivitete tjera brenda fushës së arsimit special është e inkurajuar.

Roli mbështetës: Informata mbi opsionet ndihmëse dhe mbështetja me mekanizma ndihmës, vlerësimin e nevojave dhe adaptimin në ambientin arsimor. Organizimi i transportit deri te qendra burimore mund të kërkohet. Mësimdhënësit janë gjithashtu përgjegjës për regjistrimin e informatave të nxënësit, raporteve të udhëtimit, raportet e deklaratës dhe artikujve mbi arsimin special.

Informimi i publikut: Përpjekjet për informim duhet t'i tejkalojnë shtëpitë, shokët dhe tërë komunitetin e nxënësit. Përpjekjet për informimin e komunitetit bëhen përmes vizitave të shkollave, vizitave të shtëpive, thirrjeve telefonike dhe letrave dhe përmes periodave speciale të asistimit në qendrën burimore. Ligjëratat në qendrën burimore në komunë gjithashtu mbahen për çështje pedagogjike, kushtet sociale, mundësitë arsimore dhe çështje shërbimesh për nxënësit përfshirë çështjet mjekësore.

ORGANIZIMI I SHKOLLËS

Arsimi para-shkollor

Në Kosovë, arsimi para-shkollor mund të bëhet në kopshte për fëmijë prej nëntë muaj deri në gjashtë vjet. Një vit i përgatitjes shkollore mbahet për fëmijët e moshës pesë deri në gjashtë vjet. Sistemi i tanishëm para-shkollor në Kosovë nuk është i zhvilluar shumë mirë, i mungon një planprogram formal dhe ka shume programe të ndryshme – vetëm disa prej të cilave janë të udhëhequra nga shteti. Disa institucione para-shkollore kanë filluar të përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta. Si një shembull, në komunën e Gjilanit, një edukator ishte i punësuar tash së voni kryesisht për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në çdo grup të fëmijëve mund të përfshihen dy fëmijë me nevoja të veçanta, ndonëse ky është vetëm një shembull i gjithëpërfshirjes, nuk ka një strategji gjithëpërfshirëse sistematike për fëmijët në këto shkolla. Për të filluar me sukses përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet para-shkollore në Kosovë, identifikimi duhet të bëhet herët, me qellim që të sigurohet mundësia për edukim dhe rehabilitim. Për fëmijë, rehabilitimi gjithashtu bëhet në bashkëpunim me OJQ si “Handikos” dhe asociacione të ndryshme që përfaqësojnë njerëzit me nevoja të veçanta.

Arsimi fillor

Mundësitë për nxënësit me paaftësi që të ndjekin shkollën janë rritur. Ata tani mund të ndjekin kurse në shkollat speciale, klasët e bashkangjitura ose klasët e rregullta. Numri i klasëve të bashkangjitura po rritet më shpejtësi. Megjithatë, mbetet një numër i madh i nxënësve me dëmtime të ndryshme që nuk janë në shkollë. Në Kosovë, ka shtatë shkolla speciale: pesë për fëmijë me dëmtime intelektuale, një shkollë për fëmijët me dëmtime në të dëgjuar dhe një për fëmijët me dëmtime në të parë. Nuk ka shkollë për fëmijët me dëmtime fizike ose dëmtime tjera. Megjithatë, “Handikos” ka një program për fëmijët me dëmtime fizike dhe familjet e tyre. Ka dy shkolla për fëmijët me dëmtime sensorike (dëmtime në të parë dhe dëgjuar), të cilat sot janë të paisura për t’i përmbushur standardet Evropiane. Mirëpo, atje mbetet mungesa e ndihmës për dëgjim dhe mjeteve tjera ndihmëse për dëgjim në shkollën për fëmijët me vështirësi në dëgjim. Fatkeqësisht, shkollat për fëmijët me dëmtime intelektuale nuk kanë pasur mbështetje domethënëse financiare për paisje ose materiale tjera.

Të gjitha shkollat speciale kane mësimdhënës të cilët kanë marrë pjesë në trajnimin për zhvillimin profesional ose DShEGj (Drejt Shkollës Efektive për të Gjithë) mbajtur nga FSDEK (Mbështetja Finandeze Zhvillimit të Sektorit të Arsimit) dhe defektologëve të cilët japin mësim për aftësi për nxënësit me dëmtime të ndryshme. Një numër i ekspertëve është duke u trajnuar për trajner ose mësimdhënës shtetit. Derisa numri i klasëve të bashkangjitura është duke u rritur, burimet ekzistuese janë të tendosura. Rekrutët për trajnim janë tani në zhvillim profesional; 70 mësimdhënës specialist do të trajnohen deri më 2007 përbrenda programit të DShEGj-së me disa studentë që marrin bursa për shkallen Master dhe Doktoraturë në studimet e arsimit special nga FSDEK në bashkëpunim me Universitetin e Juvaskulës në Finlandë. Përdorimi efikas i burimeve njerëzore do të jetë i domosdoshëm për të vazhduar në kursin pozitiv.

Numri i klasëve të bashkangjitura, siç është cekur më lart, është duke u rritur shumë shpejt. Momentalisht (15 Mars 2004), ka 36 klasë që funksionojnë në nivelin fillor dhe 11 klasë janë në zhvillim e sipër me tetë klasë tjera shtesë që tanimë janë planifikuar – gjithsejt 55 klasë, të gjitha në nivelin fillor. Dy nga këto klasë janë për nxënësit me dëmtime në të dëgjuar. Dy klasë tjera janë për nxënësit me dëmtime të shumfishta dhe tjerat janë për nxënës me dëmtime intelektuale. Organizimi i klasëve të bashkangjitura është një hap drejt gjithëpërfshirjes. Qëllimi kryesor është t’u ipen fëmijëve kompetencat e domosdoshme për të vijuar klasët e rregullta me shokët e tyre. Në fazen tranzicionale, mbështetje e menjëhershme është

planifikuar për mësimdhënësit në klasët e bashkangjitura për t'u mbështetur nga mësimdhënësit nga shkollat speciale.

Arsimi i mesëm profesional

Papunësia dhe mungesa e aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura janë probleme fundamentale për personat me paaftësi dhe familjet e tyre. Në të njëjten kohë, në shoqërinë Kosovare gjatë tranzicionit dhe periudhës së rindërtimit ka pasur një shkallë shumë të lartë të papunësisë në popullatën e përgjithshme (deri në 70%). Supozohet se personat me paaftësi përballen me shkallën më të lartë të papunësisë. Prandaj arsimi profesional është çështje kritike për inkorporimin e personave me paaftësi në shoqëri, pa të cilin njerëzit me paaftësi nuk do të kenë mundësi reale në tregun e punës. Në ish Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë, kanë qenë disa profesione të lëna anash për personat me paaftësi – për shembull personat me dëmtime në të parë janë trajnuar për të punuar në komutator si operator – por për shkak të teknologjisë së re këta persona janë tani të papunë. Sot, është esenciale gjetja e punës së përshtatshme për këta persona. Në disa vende, përpjekjet për punësim janë paguar. Për shembull, personat me dëmtime intelektuale janë trajnuar të punojnë në restorane dhe personat me dëmtime fizike ose dëmtime në të dëgjuar të punojnë me kompjuter.

Momentalisht janë vetëm tri zgjedhje për arsimin profesional të personave me nevoja të veçanta. *Lef Nosi*, një shkollë për personat me dëmtime intelektuale, ka 22 nxënës. Koncentrimi i tyre kryesor është në industrinë e tekstit, ndonëse shkolla planifikon të hapë një tjetër zgjedhje të re për pastrimin e veturave. *Xheladin Deda* në Pejë është një shkollë për personat me dëmtime në të dëgjuar ku 15 nxënës po trajtohen për t'u bërë fizioterapeutë. *Nënë Tereza* në Prizren është shkollë për personat me dëmtime në të dëgjuar ku 28 nxënës mësojnë aftësi si automekanikë, dizajn grafik dhe aftësi për kompjuter dhe tekstil.

Do të jetë shumë me rëndësi të selektohen të tjera fusha të studimit për arsimin profesional të përshtatshme për Kosovë. Kosova ka traditë të trajnimit profesional të bazuar në shkollë por modele të tjera gjithashtu mund të jenë të përshtatshme. Trajnimi bazuar në shkollë u jep mbështetje efektive personave me nevoja speciale. Megjithatë, çmimet e mësimdhënies janë një problem me këtë model. Tjetër alternativë janë punëtoritë-baraka të cilat gjithashtu japin mbështetje për personat me nevoja të veçanta dhe mund, nganjëherë, të jenë e vetmja mundësi për personat me dëmtime të buta dhe të rënda të gjejnë punë. Nxënësit poashtu mund të jenë në programe të kombinuara, të quajtur “sanduiç” programe, në të cilët ata lëvizin nga arsimi profesional i bazuar në shkollë në intershipe dhe prapë në trajnimin e bazuar në shkollë për rishikim. Ky model i lejon shkollës të ulë çmimet, duke ofruar arsimin teorik pa materiale ose makineri dhe nxënësit gëzojnë mundësinë të provojnë aftësitë e tyre. Më në fund, nxënësit poashtu mund të mësojnë përmes përvojës së punës, siç është e zakonshme në Gjermani. Për shembull, në këtë përvojë pune nxënësit fitojnë punë teorike në institucionet tjera për arsimin profesional. Nxënësit janë zakonisht të motivuar nga kjo mundësi sepse është praktike dhe më pak teorike (Markku Aunola, Material Mësimi për Nxënës për Zhvillimin e Arsimit Profesional dhe Trajnimit, 2003).

Në Prill të vitit 2003, disa ekspertë për arsimin profesional nga Kosova kishin një seminar një javor për arsimin special drejtuar nga një ekspert Finlandez, gjatë të cilit ata përkufizuan pesë çështje prioritare që duhet të zhvillohen në nivelin kombëtar për arsimin e mesëm profesional: kompletimi dhe aprovimi i ligjit dhe normave për arsimin e njerëzve me paaftësi; terminologjia, qasja dhe kategoritë e punësimit; bashkëpunimi inter-ministor, mbështetje për punësim dhe trajnim profesional të vazhdueshëm. Këto masa duhet të merren në konsideratë, me një mirëkuptim të limitimeve ekonomike të sistemit arsimor në Kosovë, për të krijuar strategjinë dhe politikën për arsimin profesional dhe special. Politikën për arsimin profesional të njerëzve me nevoja të veçanta duhet të ndjekin të njëjten kornizë si edhe sistemi arsimor profesional gjeneral si dhe politikën për arsimin special, me qëllim të përfshirjes së personave me nevoja të veçanta në sistemin gjeneral të arsimit dhe në shoqëri.

STATISTIKAT DHE INDIKATORËT

Të dhënat nuk janë të mbledhura rregullisht në Kosovë mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta, veçanërisht për fëmijët e moshës për shkollë të cilët *nuk* janë në sistemin arsimor, bile as në nivelin fillor. Informatat në lidhje me numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë është një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e planifikimit arsimor në të ardhmen. Njësia e Arsimit Special e MASHT-it mbledh të dhëna lidhur me fëmijët me nevoja të veçanta në shkollat speciale, në klasët e bashkangjitura në shkollat e rregullta dhe për klasët gjithëpërfshirëse. Mbledhja e të dhënave do të jetë më shumë efektive përmes bashkëpunimit multidisiplinor, përfshirë të dhënat nga organizatat shëndetësore, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe, përveç shkollave, edhe punëtorëve të programeve të rehabilitimit bazuar në komunitete.

Sipas statistikave për arsimin gjeneral në Kosovë gjatë vitit akademik 2003/2004 rreth 424 000 nxënës kanë vijuar shkollën. Rreth 14 000 ishin në arsimin para-shkollor, 330 000 në shkollën fillore dhe 80 000 nxënës në shkollën e mesme. Nëse marrim mesataren botërore të personave me nevoja të veçanta prej 2-3%, ne do të mund të konkludonim se janë më shumë se 12 000 nxënës më dëmtimë të buta deri te ato të rënda. Këtu ka, megjithatë, numër të pamjaftueshëm të shkollave speciale dhe klasëve të bashkangjitura. Kjo e vetme mund të konsiderohet një pengesë për paisjen me kushte minimale për arsimimin e këtyre nxënësve.

Nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat speciale dhe klasët e bashkangjitura

Sipas Sistemit Informativ për Menagjimin e Arsimit (SIMA), një projekt i përbashkët i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Bankës Botërore, në vitin akademik 2001/2002 (Tetor 2001) Kosova ka pasur shtatë shkolla speciale dhe shtatë klasë të bashkangjitura në shkollat e rregullta – duke bërë kështu gjithsejt 14 njësi me 503 nxënës; 343 (68%) ishin meshkuj ndërsa 160 (32%) ishin femra. Më 1999, ishin vetëm katër shkolla speciale dhe dy klasë speciale të bashkangjitura në shkollat speciale që kishin gjithsejt 400 nxënës me dëmtime të ndryshme dhe 60 mësimdhënës. Më 2002 një kategori e re, fëmijët me dëmtime të shumëfishta, ishte përfshirë gjithashtu në mbledhjen e të dhënave. Ky vit ishte gjithashtu viti i formimit të qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Gjatë vitit shkollor 2002/2003, numri i klasëve të bashkangjitura është rritur pasi që 30 klasë të bashkangjitura në 30 komuna janë themeluar. Në regjionin e Prishtinës, 8 klasë të reja të bashkangjitura janë hapur. Nga tabela më poshtë është evidente se pjesëmarrja e femrave është rritur nga 32% në vitin 2001 në 38% në vitin 2002/2003. Nga statistikat e vitit 2003/2004 mund të shihet se numri i nxënësve është rritur nga vetëm 503 në tetor të vitit 2001 në 1 046 nxënës në vitin 2003/2004. Figura 5.1 ilustron këtë rritje në numrin e nxënësve me nevoja të veçanta, sipas tipit të dëmtimit, në shkolla prej vitit 2001-2004.

Tabla 5.1 Numri i nxënësve sipas gjinisë dhe tipit të dëmtimit (2001-2004)

	2001/2002 (Tetor 2001)			2001/2002 (Prill 2002)			2002/2003			2003/2004		
	<i>m</i>	<i>f</i>	Total	<i>m</i>	<i>f</i>	Total	<i>m</i>	<i>f</i>	Total	<i>m</i>	<i>f</i>	Total
Tipii dëmtimit												
Dëmtime intelektuale	221	96	317	215	92	307	320	161	481	330	192	522
Dëmtime në të dëgjuar	89	49	138	87	46	133	137	113	250	152	113	265
Dëmtime në të parë	33	15	48	27	10	37	22	13	35	33	19	52
Dëmtime të shumfishta	n/a	n/a	n/a	17	24	41	12	11	33	124	83	207
Gjithsejt	343	160	503	346	172	518	491	298	789	639	407	1 046

Burimi: Sistemi Informativ për Menagjimin e Arsimit (SIMA), projekt i MASHT-Bankës Botërore

Figura 5.1 Përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta bazuar në të dhënat nga 2001-04




Tabela 5.2 ilustron që arsimit special në Kosovë mbahet në shtatë shkolla speciale dhe në 45 klasë të bashkangjitura me gjithsejt 1 052 nxënës më 2004. Meshkujt përfaqësojnë përafërsisht 61% të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Afërsisht gjysma e nxënësve në klasët e bashkangjitura kanë dëmtime intelektuale.


Tabela 5.2 Numri i shkollave speciale, klasëve të bashkangjitura dhe nxënësve sipas dëmtimeve (2004)

Tipi i dëmtimit	Shkollat Speciale	Klasët e Bashkangjitura	Nxënës		
			Meshkuj	Femra	Gjithsejt
Dëmtime intelektuale	5	4	330	192	522
Dëmtime në të dëgjuar	1	8	152	113	265
Dëmtime në të parë	1	2	33	19	52
Dëmtime të shumfishta	0	31	124	83	207
Gjithsejt	7	45	639	407	1 046

Burimi: Sistemi Informativ për Menagjimin e Arsimit (SIMA), projekt i MASHT-Bankës Botërore

Figura 5.2 prezanton numrin e nxënësve sipas tipit të dëmtimit, shprehur në përqindje. Shihet se përmbi 50% e fëmijëve kanë dëmtime intelektuale, 25% kanë dëmtime në të dëgjuar, 20% kanë dëmtime të shumfishta dhe 5% kanë dëmtime në të parë.

Figura 5.2 Nxënësit sipas tipit të dëmtimit (në përqindje)



Fëmijët me nevoja të veçanta që vijnë shkollat e rregullta në Kosovë

Gjithashtu sipas statistikave të Sistemit Informativ për Menagjimin e Arsimit (SIMA), projekti i MASHT-Bankës Botërore, nxënësit me nevoja të veçanta llogariten për më shumë se 2.5% e tërë popullacionit të shkollave në sistemin e rregullt arsimor. Megjithatë, është me rëndësi të cekim se dëmtimet për këta fëmijë janë kategorizuar dhe klasifikuar nga mësuesit ose prindërit dhe jo nga ekspertët. Sipas këtyre statistikave, 11 878 nxënës me nevoja të veçanta janë në shkollat e rregullta, me 1 605 nxënës në shkollat e mesme. Tabela më poshtë tregon numrin e nxënësve me nevoja të veçanta nga mosha 7 deri në 14 vjeçare (cikli fillor) që janë të përfshirë në shkollat e rregullta në Kosovë.

Tabela 5.3 Numri i nxënësve me nevoja të veçanta që vijnë shkollat e rregullta

Cikli Shkollor	Meshkuj	Femra	Gjithsejt
Para-shkollor	227	190	417
Fillor	5 245	4 611	9 856
I Mesëm	956	649	1 605
Gjithsejt	6 428	5 450	11 878

Burimi: Sistemi Informativ për Menagjimin e Arsimit (SIMA), projekt i MASHT-Bankës Botërore

Tabela na jep numër të madh të nxënësve me dëmtime të ndryshme që vijnë shkollën e rregullt. Është e mundur që mësuesit nuk e kanë kategorizuar fëmijën si do ta bënin të tjerët: nxënësit madje edhe me dëmtime shumë të buta (p.sh. me syze) mund të jenë përfshirë si fëmijë me dëmtime në të parë. Ngjashëm, nxënësit që kanë ndonjë dëmtim shumë të vogël fizik mund të kategorizoheshin si të kishin

dëmtime fizike dhe ata që mësojnë ngadalë si me dëmtime intelektuale. Prandaj mund të jetë e mundur të supozohet se këta nxënës kanë dëmtime të lehta dhe janë nxënës që mund të vijnë shkollën rregullisht, pa asnjë vështirësi të rëndësishme, së bashku me nxënësit e tjerë.

Fëmijët me nevoja të veçanta që nuk e vijnë shkollimin në regjionin e Prishtinës

Të dhënat për fëmijët me dëmtime gjithashtu mblidhen edhe nga OJQ-të në raste të caktuara. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë gjithmonë koherente nëpër organizata pasi që janë përdorur metodologji të ndryshme, kategori të ndryshme të nevojave të veçanta janë përdorur dhe burimet njerëzore të mjaftueshme për identifikimin dhe vlerësimin e këtyre fëmijëve mungojnë. Mirëpo, disa kërkime janë bërë. Sipas rezultateve nga CRIC (Centro Regionale d'Intervento per la Co-operazione) e cila monitoroi familjet me fëmijë me paaftësi në komunën e Prishtinës me 8 Korrik 2001; organizatës “Handikos” (numri i fëmijëve me dëmtime fizike); OXFAM (numri i fëmijëve me dëmtime në të dëgjuar) dhe përmes organizatave tjera që merren me persona të paaftë, janë mbledhur shënime për fëmijë për regjionin e Prishtinës. Kishte 371 fëmijë në mes të 7-14 vjeçarë të cilët nuk kishin shkollim fare ose kishin shkollim joadekuatë, fëmijë jashtë sistemit shkollor, identifikuar nga këto OJQ. Megjithatë, të dhënat janë siguruar vetëm për rajonin e Prishtinës dhe është e mundur që ka numra më të mëdhenjë në Prishtinë dhe gjetiu.

Tabela 5.4 tregon popullacionin e fëmijëve me nevoja të veçanta prej moshës 7-14 vjeçare të cilët nuk e vijnë shkollën. Meqenëse nuk ka pasur të dhëna të besueshme të popullësisë për Kosovën që nga viti 1990, ne nuk i kemi të dhënat për numrin e përgjithshëm të fëmijëve në popullatën si tërësi. Përmes mbledhjes së shënimeve për numrin e fëmijëve në regjionin e Prishtinës, të dhënat gjenerale për fëmijët me nevoja të veçanta që nuk e vijnë mësimin në tërë teritorin e Kosovës eventualisht mund të zbriten. Në tabelën në vijim, është prezantuar numri i fëmijëve me nevoja të veçanta në shtatë komuna të regjionit të Prishtinës, me klasifikim bazuar në tipin e dëmtimeve. Nga tabela, mund të shihet se numri i fëmijëve me dëmtime fizike dhe dëmtime të shumëfishta është dukshëm më i madh se numri i fëmijëve me dëmtime në të parë, dëgjuar dhe dëmtime intelektuale.

Tabela 5.4 Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta në regjionin e Prishtinës, që nuk janë të regjistruar në shkolla

Komuna	Numri i fëmijëve					Gjithsejt
	Dëmtime në të dëgjuar	Dëmtime mentale	Dëmtime fizike	Dëmtime në të pamur	Dëmtime të shumëfishta	
Prishtinë	9	6	42	7	60	124
Podujevë	7	21	74	1	20	123
Obiliq	2	3	18		7	30
Fushë Kosovë	2	3	10		10	25
Glllogovc	5	0	23		0	28
Shtime	3	0	5		6	14
Lipjan	2	2	10		13	27
Gjithsejt	30	35	182	8	116	371

Burimi: Këto të dhëna janë nga disa OJQ: CRIC, Handikos, OXFAM dhe kërkimeve të FSDEK-së.

PLANI STRATEGJIK PËR ARSIMIN E FËMIJËVE ME PAAFTËSI

Pjesa në vazhdim është një përmbledhje dhe pasqyrë e *Planit Strategjik për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në Kosovë*, dokument i dalur së fundi që themelon vizionin, misionin dhe qëllimet e

procesit të reformave. Dokumenti është përgatitur nga njësia e arsimit special të MASHT-it në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë (FSDEK) dhe është aprovuar nga MASHT në vitin 2003. Këto qëllime do të arrihen përmes strategjive të ndryshme dhe do të implementohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Vizioni i politikës së arsimit për personat me nevoja të veçanta është gjithëpërfshirja. Plani konstaton se “nxënësit me paaftësi duhet të integrohen në klasët e rregullta në vend të ndarjes së tyre në shkollat speciale”. Kosova është e vetëdijshme për faktin se ky do të jetë një proces i gjatë dhe i vështirë, që ndoshta do të marrë dhjetë vjet ose më shumë. Implementimi do të bëhet duke u bazuar në qasjen hap-pas-hapi. MASHT, në bashkëpunim me FSDEK, ka përpiluar politikën, ligjin dhe planprogramin mësimor për nxënësit me nevoja të veçanta në Kosovë. Ekspertë po trajnohen për të ardhmen e arsimit special përfshirë implementimin e politikave, ndonëse pak ekspertë të trajnuar janë momentalisht në pozita kyçe. Mësimdhënësit e shkollave speciale janë duke u trajnuar e poashtu edhe mësimdhënësit nga shkollat e rregullta. Një tjetër hap i rëndësishëm në përmbushjen e këtyre qëllimeve është trajnimi i personave të tjerë të cilët vijnë në kontakt me këta fëmijë, siç janë personeli mjekësor, punëtorët social e madje edhe krijuesit e politikave të arsimit; të gjithë do të mund të fitonin nga arsimit i shkuar përpara. Arritjet e këtyre pak viteve të kaluara janë vetëm fillimi – një pjesë e madhe mbetet për t’u bërë.

Me qëllim të racionalizimit të financave dhe zvogëlimit të personelit administrativ në shkollat fillore dhe të mesme speciale me programe rezidenciale, MASHT ka startuar integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta, duke themeluar klasë të reja të integruara në të gjitha 30 komunat e Kosovës. Përpjekjet për zhvillimin e sistemit për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta do të kërkojë që çdo shkollë të krijoj kushte dhe ambiente të ngjashme drejt arritjes së qëllimeve të mëposhtme:

- Qëllimi 1: Sigurimin e arsimit për të gjithë.
- Qëllimi 2: Sigurimin e hapësirës shkollore që i përgjigjet nevojave të fëmijëve (*p.sh.* me pjerrësi dhe toaleta speciale) në të gjitha shkollat me klasë speciale.
- Qëllimi 3: Arritjen e rezultateve të pranueshme të të mësuarit në përputhje me standardet ndërkombëtare në të gjitha nivelet e arsimit.
- Qëllimi 4: Inkurajimin e prindërve dhe shoqërisë për të mbështetur arsimin special.
- Qëllimi 5: Trajnimin e mësimdhënësve për arsimin special.
- Qëllimi 6: Adaptimin e planprogramit të shkollës.
- Qëllimi 7: Zhvillimin e pedagogjisë së përshtatshme.
- Qëllimi 8: Informimin e publikut për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin e arsimit.

Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit për të gjithë

Ministria e Arsimit do të punoj në vazhdimësi të regjistrojë nxënës në nivelet e përshtatshme shkollore pa adresim të gjinisë, etnicitetit, religjionit ose pozitës socio-ekonomike. Identifikimi, dijagnostifikimi, trajtimi dhe arsimit i fëmijëve me nevoja të veçanta janë në strategjinë afatgjatë të MASHT-it, që ka përpjekje të arsimit special të centralizuara, planifikim të krijojë qasje të barabartë dhe profesionale për të gjithë dhe t’i integrojë gradualisht këta fëmijë në shkollat e rregullta dhe në shoqëri. Për t’i arritur këto qëllime në arsimin gjithëpërfshirës, ka nevojë të vazhdohet një qasje e barabartë në arsim për të gjithë nxënësit me paaftësi në të gjitha nivelet e arsimit. Gjithashtu të domosdoshme janë aprovimi i

legjislacionit të arsimit gjithëpërfshirës dhe një plan i qartë i arsimit për të gjithë. Angazhimi i mësimit në shkollave speciale do të jetë esencial për implementim. Mbështetja për intervenim të hershëm në arsim me ndihmën e institucioneve para-shkollore është gjithashtu e kërkuar. Ndërtimi i kapaciteteve për personelin, burimet institucionale dhe njerëzore, trajnimi për arsimin gjithëpërfshirës dhe mbështetja e mësimit në mjedise të ndryshme do të nevojiten për të implementuar arsim cilësor. Veç kësaj, përkrahja e hulumtimit efektiv, sigurimi i paisjeve dhe hapësirës së përshtatshme për të mësuarit efektiv dhe të siguruarit se përkrahja arsimore është e përshtatshme për të gjithë nxënësit janë të gjitha të domosdoshme. Rritja e informimit për arsimin gjithëpërfshirës në përputhje me principet e të drejtave të njeriut do të ndihmojë në vendosjen e komunitetit përkrahës.

Është qenësorë që MASHT ka një strategji për të përfshirë të gjithë nxënësit e marginalizuar në sistemin arsimor. Secili nxënës duhet të pajiset me kushte të përshtatshme për mësim cilësor përgjatë jetës së tyre pa marrë parasysh nacionalitetin, gjininë, religjionin ose aftësinë e tij. Dy hapa nevojiten për të arritur këto qëllime. Së pari, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor përmes themelimit të klasëve të bashkangjitura dhe e dyta, përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasët e rregullta në këto shkolla. Brenda çdo komune, së paku një “klasë e mësimit” që përfshin përafërsisht dhjetë nxënës të moshave të ndryshme me paaftësi të ndryshme duhet të hapet. Inkorporimi i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë jashtë shkollës do të përfshijë identifikimin dhe kategorizimin bazuar në paaftësinë e tyre. Fëmijët me paaftësi fizike do të vijnë në mësimin në një nga klasët speciale për gjysmë-ndërrimi arsim special dhe gjysmë-ndërrimi arsim të rregullt. Mësimit special mbështetës të kualifikuar me kapacitet që të japin dijagnozë funksionale të nxënësit, të verifikojnë shkallën e paaftësisë dhe të vënë në pah aftësitë e nxënësve duhet të jenë vegël për integrimin e këtyre fëmijëve në shkolla të rregullta.

Qëllimi 2: Sigurimi i hapësirës shkollore që i përgjigjet nevojave të nxënësve

Ky qëllim është të zhvillojë ambientin e shkollës përmes zgjerimit ose përshtatjes së infrastrukturës së shkollës (pjerrësitë, toaletet, etj.) për nxënësit me nevoja të veçanta. Në këtë proces dhe në fazat tjera, prioritet do të jetë përmirësimi i infrastrukturës së shkollës për nxënësit me nevoja të veçanta. Të gjitha shkollat, deri tani, kanë qenë të përshtatshme vetëm për personat që nuk kanë të meta. Për të evituar barrierat, shkollat ekzistuese duhet të ndërtojnë anekse të reja për t'i adaptuar shkollat ose të përfshijnë zgjedhje të tjera në objektet e vjetra. Bazuar në vlerësimet në teren, më shumë se 200 shkolla janë rikonstruktuar me ndihmë e organizatave ndërkombëtare, por vetëm disa shkolla janë adaptuar për nxënësit me karroca të invalidëve. Projektet për përmirësimin e hapësirës shkollore janë shumë të shtrenjta. Megjithatë, disa fonde ka mundësi të sigurohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, tjera burime alternative janë përmes donatorëve. Për shembull, Caritas-i Gjerman ka donuar fonde për rikonstruktimin e shkollës speciale “Nëna Tereze” në Prizren. Në vitin 2002, MASHT ka investuar në paisje gjithëpërfshirëse pjerrësi dhe toaleta speciale në 30 shkolla ku janë klasët e bashkangjitura – një në secilen komunë të Kosovës. Si rezultat, ka pasur rritje të ndërrimeve gjatë ditës nga një në dy, rritje të orëve punuese për mësimit dhe nxënësit në shkollë dhe përmirësim të kushteve të punës gjithëpërfshirëse të mësuarit, dhënie e mësimit dhe sigurinë. Ka pasur gjithashtu paisje speciale për nxënësit me dëmtime në të dëgjuar dhe parë.

Qëllimi 3: Arritja e rezultateve të pranueshme të të mësuarit në përputhje me standardet ndërlombëtare në të gjitha nivelet e arsimit

Për të arritur cilësi në arsimin special, momentalisht ka një përgatitje për përmirësimin e planprogramit dhe zhvillimin e standardeve arsimore. Kjo është për të inkurajuar specifikisht arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta sipas nivelit të arsimit dhe tipit të dëmtimit. Veç kësaj, Kosova është momentalisht në fazë zhvilluese për përdorimin e planeve individuale arsimore. Zhvillimi i një planprogrami të ri kombëtar, në harmoni me standardet botërore, do të ndërmerret për të gjitha nivelet dhe klasët. Këto planprograme do të përfshijnë lëndë për nivelin fillor duke ofruar burime (tekste mesimi,

paisje teknologjike, rrjete librarish, etj.) që do të sigurojnë mundësi për nxënësit që të pajisën me aftësi dhe dituri të reja të domosdoshme për sfidat e jetës ditore.

Shërbimi i arsimit special do të bashkëpunojë me asociacione qeveritare dhe joqeveritare dhe asociacionet e personave me paaftësi me qëllim të ndarjes së përvojave të dobishme në zhvillimin e planprogramit të ri, zhvillimit të standardeve, trajnimin e mësimit dhe personelit tjetër për të gjitha aktivitetet dhe projektet në shërbimin e arsimit special. Rezultatet e këtyre përpjekjeve do të jenë numri i rritur i nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor, rritja e efikasitetit të gjetjes së punës pas shkollës së mesme profesionale, më shumë të diplomuar që me sukses i tejkalojnë sfidat e jetës së përditshme me kreativitet individual dhe shmangien e joefikasitetëve në sistemin arsimor që rezultojnë si mungesë e profesionalizmit, diskriminimit dhe madje edhe të korrupsionit.

Qëllimi 4: Inkurajimi i prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi për të mbështetur arsimin special

Shkollat, për të qenë të suksesshme, duhet të përkrahen nga komuniteti. Shkolla duhet të jetë e hapur ndaj shoqërisë në përgjithësi dhe duhet të përqipet për rritjen e përfshirjes së prindërve në vendim-marrjen e shkollës. Kjo do të përfshijë krijimin e këshillit të prindërve në nivelin shkollor, komunal dhe qendror (MASHT) për të prezantuar interesat e prindërve në sistemin arsimor. Ligji i tanishëm për arsimin fillor dhe të mesëm përkufizon të drejtat e prindërve si më poshtë:

- Krijon bashkëpunim të mirë në mes të nxënësve, prindërve, shkollave, institucioneve dhe vendeve punuese për të siguruar se fëmijët e tyre do të arsimohen në harmoni me këtë ligj.
- Një mënyrë për t'i prezantuar ankesat të mësimit, drejtori i shkollës, komuna dhe të MASHT lidhur me cilësinë e arsimit.
- Krijon një udhëzues për shërbimet dhe personelin e shkollës; dhe pjesëmarrjen në zgjedhjen e këshillit të shkollës.

Reformat drejt arsimit gjithëpërfshirës janë më të suksesshme kur prindërit ftohen si partnerë për të planifikuar arsimin në çdo shkollë. Prindërit gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në strukturimin e qëllimeve të arsimit për fëmijët e tyre. Ata janë më familjarët me personalitetin, kapacitetet, vështirësitë dhe aktivitetet e favorizuara të fëmijëve të tyre. Prindërit duhet të ftohen të përfshihen në zhvillimin e planprogramit në shkollë. Ata duhet të binden se ata janë një faktor shumë me rëndësi në zgjedhjen e vështirësive të nxënësve e sidomos në kontributin në zhvillimin e planit individual arsimor (PIA). Prindërit dhe edukatorët duhet vazhdimisht ta pyesin veten: “Si duhet t'i përgatisim fëmijët tanë që të luajnë, punojnë, mësojnë në mënyrë të pavarur dhe të mbijetojnë tash dhe në të ardhmen?”. Planifikimi, modifikimi dhe zbatimi i planit individual arsimor do të jetë më efektiv nëse përpjekjet jashtë-shkollës gjithashtu përfshihen. Me fjalë të tjera, prindërit duhet të jenë të informuar për metodat bazike të përkrahjes së zhvillimit të fëmijëve të tyre dhe të të mësuarit në ambientin shtëpiak dhe lagje.

Rekomandohet që ministria gjithashtu të marrë në konsideratë tipet e mëposhtme të përfshirjes së prindërve: Këshillet e prindërve duhet të formohen në të gjitha shkollat profesionale dhe shkollat me klasë të bashkangjitura, duke përcjellur propozimin e draft ligjit për arsimin. MASHT duhet të konsultojë prindërit për planprogramin e ri dhe përpjekjet e integritit në shkollat e rregullta. MASHT duhet të kërkojë që të gjitha shkollat profesionale të formojnë kodin e kontaktit të mësimit që prezanton emrin e mësimit dhe adresën kontaktuese në rast të nevojës së prindërve për t'i kontaktuar ata me ndonjë pyetje apo ankesë. MASHT duhet gjithashtu të zhvillojë ambiente më të mira pune dhe mësimi në institucionet zyrtare ku prindërit ndjehen të përfshirë në arsimimin e fëmijëve të tyre dhe e njohin edukatorin si partner. Prindërit duhet të përfshihen në punë vullnetare në klasë – duke kryer detyra si lexim, përkrahjen dhe zhvillimin e materialeve, mbajtjen e ambientit të shkollës të pastër ose duke dhuruar

përkrahje financiare për të përmirësuar programet. Së fundi, MASHT mund t'i përkrahë shkollat ashtu që ato mund të publikojnë fletushka informative për komunikim më të mirë me prindërit dhe komunitetet.

Në Kosovë, përkrahja nga të afërmit dhe shokët është gjithashtu qenësore, sepse sektori i arsimit formal nuk është për momentin në gjendje të sigurojë të gjithë mbështetjen e duhur. Asistenca hap-pas-hapi është e domosdoshme për secilën familje që ka fëmijë me dëmtime; familjet nuk duhet të lihen jashtë shoqërisë, sidomos prej kontaktit të përditshëm me fqinjët, esenciale për fëmijët dhe të gjithë anëtarët e familjes. Mësimdhënësit duhet të inkurajojnë prindërit të sigurojnë mundësi për fëmijët e tyre të kenë kontakt me shokët e tyre. Të gjithë fëmijët, madje edhe ata me dëmtime serioze (siç janë fëmijët me paralizë cerebrale) mund të marrin pjesë në aktivitete. Për shembull, nëse djemtë tjerë luajnë futboll në rrugë, përfshirja do të mund të thoshte që djaloshi me karrocë invalidësh shikon lojën dhe pas çdo goli roli i tij është të hedhë topin. Djemtë e tjerë mund të informohen për cerebral palsy dhe pastaj ata mund të adoptojnë një qëndrim përfshirës dhe të imagjinojnë si mund ta përfshijnë atë në aktivitetet tjera. Detyrat e përditshme në jetën e përditshme janë poashtu të rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve, duke siguruar aktivitete pozitive për fëmijët me nevoja të veçanta. Të rriturit gjithashtu mund të ndihmojnë fëmijët me dëmtime të kenë një rol domethënës në aktivitetet ditore të familjes.

Rezultatet efektive në arsimin special do të reflektojnë zhvillimin e shoqërisë, ekonomisë, kulturës dhe shkencës. MASHT do të jetë shumë i hapur ndaj publikut, duke kërkuar përkrahje nga segmente të ndryshme të shoqërisë – prindërve, sektorit privat dhe ekspertëve nga fusha të ndryshme publike dhe kulturore. Kjo do të krijojë informim dhe qëndrime pozitive drejt arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe do të mobilizojë perpjekjet në arsimimin e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë.

Qëllimi 5: Trajnimi i mësimdhënësve për arsimin special

Mbështetja Finlandeze për Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë (FSDEK) ka organizuar trajnim brenda shërbimit regional për mësimdhënësit trajner në pesë regjione në Kosovë. Kjo është një pjesë e programit për të rritur kapacitetin e shkollës. Trajnimi për mësimdhënësit trajner filloi në vjeshtë të vitit 2001 dhe vazhdoi deri në vitin 2004. FSDEK trajnoi 16 trajnerë regjionalë dhe këta trajnerë trajnuan më shumë se 300 mësimdhënës gjatë vitit shkollor 2002/2003. Gjatë këtyre seancave trajnuese, ata u fokusuan në trajnimin e 130 mësimdhënësve të tjerë si dhe personelit tjetër në shkollat ku ka kurse të reja speciale. Me qëllim të sigurimit të mbështetjes për trajnimin mbi arsimin gjithëpërfshirës, MASHT gjithashtu kontrakttoi 14 trajnerë dhe pagoi kompenzimin e tyre gjatë dy viteve të fundit.

Veç kësaj, rekomandohet që ministria të përkrahë idenë e Fakultetit Pedagogjik si institucion përgjegjës për trajnimin e mësimdhënësve lidhur me arsimimin e fëmijëve me paaftësi. Veç kësaj, një institucion pedagogjik duhet të zhvillojë një praktikum për mësimdhënës si pjesë e planprogramit të trajnimit të mësimdhënësve. MASHT mund të bashkëpunojë me shkollat speciale për të siguruar mësim praktik për mësimdhënësit që trajnohen. Ndryshimet në planprogramin për trajnimin e mësimdhënësve dhe theksimi i çështjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe qasjet moderne të të mësuarit dhe mësimdhënies gjithashtu rekomandohen. MASHT mund të kërkojë përkrahje nga FSDEK të përfshihet në trajnimin e mësimdhënësve për të shfytëzuar modelin e TESFA-B (trajnim për trajnerë) për së paku një grup-bërthame të trajnerëve lokalë, bazuar në komunat kyçe për sigurimin e mbështetjes afatgjate. Më në fund, MASHT mund të mbështesë Grupin Punues FSDEK me zhvillimin dhe përkrahjen e politikave të arsimit, zhvillim profesional për trajnerë dhe hulumtues të politikave, trajnim në procesin e zhvillimit të shkollës dhe zhvillimin dhe prezantimin e draftit punues për këtë projekt ministrit.

Qëllimi 6: Adaptimi i planprogramit të shkollës

Bazuar në ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe kornizës së re të planprogramit në Kosovë, arsimi special i plotëson nevojat individuale për fëmijët me nevoja të veçanta si pjesë e sistemit të

arsimit të rregullt. Megjithatë, përmbajtja e lëndëve dhe fondi i orëve nuk i korrespondon sistemit gjeneral të arsimit dhe kornizës së re të planprogramit në Kosovë. Një ekspert nga arsimit special është angazhuar në hartimin dhe përpilimin e standardeve të arsimit para-shkollor në Kosovë. Kjo përfshinë planprogramin për një politikë gjithëpërfshirëse që kërkon që të gjithë nxënësit në shkollat speciale, klasët e bashkangjitura dhe klasët e integruara të plotësojnë kërkesat e njëjta të planprogramit bazë sikur nxënësit në shkollat e rregullta por bazuar në planin individual arsimor.

Gjithashtu, krijimi i një *Grupi Punues Ekspertësh për Arsimin Special* ishte propozuar për vitin akademik 2003/2004 që eventualisht do të marrë pjesë në zhvillimin e planprogramit përfshirës dhe planprogramit të arsimit special. Ky grup do të marrë pjesë në konsultimin dhe vlerësimin e grupeve të ekspertëve për zhvillimin e planprogrameve sipas lëndëve. Të gjitha adaptimet dhe zgjerimet e planprogramit duhet të definohen në PIA. Nuk ka ndonjë planprogram specifik për arsimin special, pasi që nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevoja dhe dëmtime në mësim të ndryshme. Programi i njëjtë nuk mund të jetë efektiv për të gjithë. Bërthama e planprogramit duhet të modifikohet pjesërisht. Kjo është arsyeja pse mësimdhënësi i arsimit special duhet të vlerësojë kapacitetet dhe vështirësitë në mësim të nxënësve dhe të përgatisë planin individual. Planet individuale arsimore përcjellin bërthamën e planprogramit sa më shumë që të jetë e mundur, por objektivat individuale të të mësuarit mund të modifikohen bazuar në mundësitë reale për arritjen e nxënësve. Momentalisht, planifikimi i përmbajtjes së lëndëve për fusha të ndryshme ka filluar për lëndët përfshirëse, lëndët profesionale dhe në arsimin para-shkollor. Sipas draft planprogramit për klasët II, VII dhe XI, tre ekspertë nga arsimit special duhet të marrin pjesë në lëndet përfshirëse për secilën klasë përfshirë një ekspert për dëmtime në të dëgjuar, një ekspert për dëmtime intelektuale dhe një ekspert për dëmtime në të parë.

Eksperti për dëmtime intelektuale do të hartojë programet për parandalimin, e poashtu edhe për kujdesin social dhe mjekësor të fëmijëve me dëmtime intelektuale. Në nivelet më të avancuara, qëllimet kryesore do të jenë të zhvillohen aftësitë jetësore dhe sociale, aftësitë e gjuhës, konceptet elementare matematikore, njohja e ambientit, zhvillimi i informatave dhe aftësitë tjera muzikore dhe artistike dhe zhvillimi i shëndetit përmes aktiviteteve fizike. Në këtë fazë, nxënësit duhet të zhvillojnë aftësi mësimi në nivelin e shkollës fillore duke përfshirë leximin, shkrimin dhe matematikën. Në shkollën e mesme, nxënësit nga kjo kategori zakonisht janë të përgatitur për zanate sipas nevojave të tregut punues.

Eksperti për dëmtime në të parë do të hartojë planprogramin për nxënësit me dëmtime në të parë dhe integrimin e tyre në shkollat e rregullta. Forma alternative të të lexuarit dhe shkruarit, përfshirë Barill-in për nxënësit e verbër, tekste të shtypura me shkronja të mëdha dhe libra të incizuara duhet të përfshihen. Në shkollat e mesme, nxënësit mësojnë nga përmbajtja e ngjashme me atë në shkollën fillore; integrimi i këtyre nxënësve në shoqëri dhe shkolla duhet të bëhet përmes lëndëve shtesë. Kjo mund të përfshijë teknologjinë informative, që është e njëjtë si në shkollat e rregullta, ku nxënës të verbër punojnë me teknologji ndihmëse dhe Internet. Orientimi dhe lëvizshmëria mëson aftësi lëvizëse të pavarura. Për nxënësit e verbër, kjo mund të përfshijë mësimin se si të përdoret shkopi i bardhe për lëvizje të pavarur. Puna shtëpiake dhe ekonomia familjare mëson aftësi për jetën e përditshme – zierje, veshje, aftësi praktike të jetës dhe higjienë personale. Fizioterapeuti ka qëllim ta përgatisë nxënësin për profesione teknike. Terapija me masazh është një mundësi punësimi pas diplomimit. Arsimimi i mëtutjeshëm në arsimin e lartë është gjithashtu i mundur. Kurset e ndërmarrjeve telefonike kanë për qëllim përgatitjen e nxënësve për qendra të thirrjeve telefonike, sidomos atyre digjitale. Teknikët për përpunimin e drurit, montimin e mobiljeve dhe thurjen e shportave mësojnë këto zanate të veçanta për tregun e punës.

Eksperti për dëmtime në të dëgjuar do të hartojë planprogramin me aftësi bazike në zhvillimin e të folurit dhe gjuhës së shenjave për nxënësit me dëmtime në të dëgjuar. Nxënësit e shurdhër mësojnë nga përmbajtja e ngjashme me atë në shkollën fillore. Në shkollat e mesme, këta nxënës do të integrohen në shkolla të rregullta kurse nxënësit me dëmtime të rënda dëgjimi mund të vazhdojnë në arsimin profesional dhe në arsimimin e mëtutjeshëm. Një numër i nxënësve që zhvillon aftësi të mira duhet të inkurajohet të

vazhdojë në arsimin e lartë. Nuk duhet të ketë limitime sa i përket asaj se çka mund të arrijnë njerëzit me paaftësi.

Plani arsimor dhe sasia e orëve të mësimit

Plani arsimor i shkollës duhet të korrespondojë me hapësirën e përshtatshme punuese; përfshirë përforsimin e vazhdueshëm në zhvillimin e gjuhës, matematikës dhe aftësive tjera. Shpesh, mësimdhënësit e klasëve me fëmijë me nevoja të veçanta, klasë të bashkangjitura dhe klasë speciale nuk e përcjellin me përpikmëri fondin e orëve të planifikuar (ndërrimeve) siç janë planifikuar nga ligji mbi arsimin fillor dhe atë të mesëm. Në këto klasë, jo të gjithë mësuesit e përcjellin planin arsimor dhe fondin e orëve për arsimin e regullt. Shumica e mësimdhënësve janë duke punuar për herë të parë me nxënës me nevoja të veçanta dhe ende nuk kanë trajnim të mjaftueshëm për planet arsimore dhe fondin e orëve për këto klasë. Në ligjin mbi arsimin fillor dhe atë të mesëm (kapitulli VII) thuhet se nxënësit në arsimin special duhet të kenë numër të njëjtë të orëve në përgjithësi krahasuar me nxënësit tjerë. Autoriteti qëndror arsimor në lidhje me arsimin special thekson strukturën e lëndëve të detyrueshme dhe aktiviteteve në planprogram, numrin maksimal të orëve për javë për klasë specifike, numrin minimal të orëve për lëndët bazike dhe poashtu jep instruksione të mëtutjeshme për planin individual arsimor. Kohëzgjatja e vitit arsimor është 37 javë, ndërsa numri maksimal i orëve për javë sipas planprogramit të ri arsimor të Kosovës është prezantuar në tabelën më poshte:

Tabela 5.5 Orët mësimore për javë në klasë të ndryshme

	Klasët								
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Orët e mësimit për javë	20	21	23	24	25	27	29	30	30

Burimi: Planprogrami arsimor i Kosovës

Nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat speciale, klasët e bashkangjitura ose shkolla të rregullta ndjekin planprogramin e rregullt (i modifikuar si plani individual arsimor) dhe ata kanë të njëjtin fond të orëve si edhe shokët e tyre në klasë të rregullta. Mësimdhënësi nuk është i lëjuar të zvogëlojë numrin e orëve për nxënësin ose klasën. Nëse numri i orëve në këto klasë zvogëlohet atëherë mundësia për sukses të këtyre nxënësve dhe inkorporimi i tyre në klasë të rregullta është i rrezikuar së bashku me mundësinë për të implementuar një politikë efektive gjithëpërfshirëse.

Plani individual arsimor duhet të lejojë metodologji bashkëveprimi me fokusim në nxënës. Nxënësve mund t'iu nevojiten me shumë se 45 minuta (kohëzgjatj tipike e orës). Planet duhet gjithashtu të lejojnë përdorimin e strategjive të ndryshme të mësimdhënies sipas nevojave të studentëve. Planet individuale arsimore janë të çmuara për nxënësit në klasët gjithëpërfshirëse.

Plani Individual Arsimor (PIA)

Plani Individual Arsimor zhvillon një program për nxënësin, të përgatitur sipas nevojave unike të tij apo asaj, për të tejkaluar pengesat në mësim. Ai specifikon objektivat për nxënësit me nevoja specifike me të dhënat e prindërve, mësimdhënësve dhe vetë nxënësve, nëse është e mundur, dhe synon ta përfshijë nxënësin si nxënës aktiv. Planet individuale arsimore e zbërthejnë të mësuarit për të parë më mirë ndryshimet në dituri, aftësi jetësore dhe zhvillimet socio-kulturore. Ai mund të shkruhet në formë të lirë ose të dizajnohet duke përdorur struktura të caktuara të krijuara më heret. Korniza gjenerale e arsimit të PIA-së është e bazuar në dijagnozë dhe përshinë një planprogram individual dhe vlerësim të vazhdueshëm të punës. Puna individuale përmes PIA-së inkurajon arritje dhe sukses më të madh sepse i plotëson më

mirë nevojat e secilit nxënës. Qëllimi kryesor i një plani të tillë të mësimit individual është të inkurajojë nxënësit me nevoja të veçanta të ballafaqohen me sfida të ndryshme në procesin e mësimin, të zhvillojnë vetëbesim dhe vetërespekt më të madh siç është cekur në kornizen e re të planprogramit të Kosovës. PIA-të duhet të përfshijnë aftësi zhvilluese mentale ose fizike, zhvillime mentale (kapacitetin për të kuptuar idetë abstrakte) dhe zhvillime sociale (aftësinë e bashkëpunimit me të tjerët) si komponente. Planet punuese, që mund të jenë afatshkurta ose afatgjate, duhet të jenë të përshtatshme për planprogramin dhe të përfshijnë elemente që duhet të mësohen në lëndë të ndryshme, si në matematikë, gjuhë amëtare, lëndët sociale, aftësitë dhe arti.

Qëllimi 7: Pedagogjia

Të mësuarit është proces jetësor i marrjes së njohurive, aftësive dhe shprehjeve të reja. Mirëpo, ai nuk është gjithmonë i arritur lehtë për të gjithë. Një numri të konsideruar të nxënësve do t'i nevojitet ndihmë mësimdhënëse e vazhduar dhe të gjithë fëmijët duhet të inkurajohen, t'u ipet shpresë dhe vetëbesim. Vështirësitë në mësim mund të jenë të natyrave të ndryshme. Më të shpeshtat janë: gjuha dhe komunikimi, si në artikulum, shprehje ose lexim (dysleksia); vështirësi me aftësi specifike akademike në të shkruar ose matematike (dyskalkulia) dhe vështirësi të tjera në koncentrim ose kujtesë. Të gjitha mund të jenë pasoja të dëmtimeve të natyrës fizike, mentale ose emocionale shkaktuar nga faktorët gjenetik, organik ose ambiental.

Mësimi për grupet e ndryshme

Përderisa të mësuarit është proces individual, mësimdhënia është kolektive, me mësuesin që udhëheq procesin mësimor për secilin nxënës. Siç ka thënë Howard Gardner, psikolog i famshëm arsimor, “Nuk është me rëndësi sa je i zgjuar, por në cilat lëndë je i zgjuar. Si qenie njerëzore, ne të gjithë posedojmë aftësi për të zgjidhur probleme të natyrave të ndryshme”. Prandaj, pyetja është cilat janë rrugët me të mira për mësimdhënësin ta udhëheqë të mësuarit në mënyrën që i përfshinë të gjithë nxënësit? Mësimdhënësi ka shumë role, përfshirë si burim të informatave, si shembull, mbikqyrës dhe organizator. Mësimdhënësit i udhëzojnë nxënësit në kërkimin e informatës në mënyrë të pavarur dhe të zgjedhin problemet me ndihmën e tyre. Për arsimin special, mësimdhënësve ju nevojitet kohë e mjaftueshme për të mësuar nxënësit me nevoja të veçanta si dhe tolerance, durim, motivim dhe dituri për procesin mësimdhënës. Mësimdhënësit duhet të jenë të aftë të kombinojnë formate dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies që marrin parasysh aftësitë e nxënësve dhe vështirësitë e tyre – duke krijuar në këtë mënyrë një ambient mirëpritës dhe të qasshëm. Megjithatë, në shumë shkolla në Kosovë, stili klasik i ligjërimit aplikohet ende dhe ky tani konsiderohet si më pak efektiv sesa metodat tjera të diskutuara më poshtë.

Mësimi në bashkëpunim arrihet kur nxënësit punojnë së bashku, në çifte dhe grupe, për ta zgjidhur problemin kolektivisht. Prosesi i bashkëpunimit është pjesë natyrale e zhvillimit të fëmijës. Nxënësit duhet t'i ndihmojnë njëri-tjetrit duke ndarë dhe duke përkrahur njëri-tjetrin. Mësimdhënësit duhet të krijojnë kushte të duhura për mësim bashkëpunues. Bashkëpunimi i klasës është një aspekt i rëndësishëm. Karakteristikat përfshijnë: kohezionin e grupit, pavarësinë, koordinimin dhe vrojtimin dhe intervenimin e mësimdhënësit. Veç kësaj, një ambient përkrahës duhet të krijohet me kujdes i cili është i përshtatshëm për nxënësin në përputhje me stilin e tyre individual të mësimin. Solidariteti në mes të anëtarëve të grupit mund të inkurajohet, duke kultivuar pavarësinë, stimulimin social dhe bashkëveprimin, përfshirë numër të madh të lëndëve. Mësimi aktiv realizohet nëse nxënësit mësojnë në bashkëpunim me të tjerët. Forma tjera të bashkëpunimit përfshijnë “teknikën xhigsav” (loja me enigmë), që iu lejon nxënësve në grup të bëhen ekspertë në lëndë të caktuara dhe ta ndajnë diturinë e tyre me të tjerët në grup. Rezultatet pastaj perputhen së bashku si pjesë të një enigme. Leximi në çifte iu lejon nxënësve të bashkëveprojnë me tekstin dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin, duke dëgjuar me kujdes dhe duke ndarë me klasën. Tryezat e rrumbullakta janë një metodë tjetër e bashkëpunimit që i stimulon nxënësit të zgjerojnë njohuritë e tyre në procesin e prezantimit dhe vrojtimit të problemit nga pikëvështrime të ndryshme. Me metoden e quajtur “parashiko

me kushte paraprake”, nxënësit krijojnë një tregim ose përshkruajnë një karakter bazuar në katër kushtet paraprake. Një metodë tjetër i inkurajon nxënësit të mendojnë lirshëm për çështje të caktuara dhe të krijojnë marrëdhënie në mes të fakteve në “tufëz”. Diagrami i Venit u lejon nxënësve që logjikisht të ndajnë ose të gjejnë ngjashmëri në tri fenomene, koncepte ose histori. “Unë e di/Unë dua ta di/Unë kam mësuar” është metodë që merr parasysh diturinë e mëhershme të nxënësit dhe verifikon nivelin e diturisë së fituar.

Të gjitha këto metoda krijojnë një ambient që është i dobishëm për nxënësit që kanë vështirësi në mësim, duke ua mundësuar atyre të kenë qasje të shumëfishta për secilin aktivitet. Realizimi i këtyre strategjive i mundëson mësimdhënësit të hulumtojë talentet dhe dobësitë e secilit nxënës. Gjithashtu, mësimdhënësit duke marrur parasysh dëmtimet mund ta modifikojnë klasën, përfshirë pozitën e bankave dhe strukturën e grupit, për t’i përmbushur më së miri nevojat e secilit student. Mësimdhënësi gjithashtu mund t’i inkurajojë nxënësit me kombinim të metodave të ndryshme dhe mundësitë të shprehin mendimet e tyre lirshëm. Formatet e ndryshme arsimore që u përmendën më lart inkurajojnë mësimdhënien aktive dhe udhëheqin procesin e mësimin. Poashtu, kur nxënësit bashkëpunojnë me njëri-tjetrin mësimdhënësi do të ketë kohë shtesë të punojë me nxënësit individualisht.

Materialet për mësimdhënie të përpiluara nga mesimdhënësi

Për momentin, ende ka pak materiale për mësimdhënësit, tekste punuese për fëmijë dhe libra që mund të lexohen nga fëmijët. Mësimdhënësit kryesisht përdorin materiale si dhe libra për mësim dhe për ushtrime që sigurohen nga autoritetet arsimore. Përderisa kjo i plotëson disa kërkesa, mësimdhënësit poashtu u nevojiten materiale shtesë për ta bërë mësimin më efektiv. Kjo është prandaj pjesë esenciale e rolit të mësimdhënësit të përgatitë dhe mbledh materiale tjera që janë të përshtatshme për nevojat e nxënësve në klasë. Mësimdhënësit duhet të adaptojnë dhe prodhojnë materiale në baza të rregullta. Shembuj të tjerë të materialit mësimdhënës përfshijnë fotografi, harta, libra, gazeta, revista, kalendarë ose madje edhe objekte si fruta për të ilustruar mësimin e dhënë. Si shtesë, poezia dhe muzika mund të përdoren si mjete për kujtesë për të mësuar fjalor të vështirë ose lëndë tjera. Teknologjia është e mirëseardhur kur është e mundur – në formën e televizionit, radios ose video dhe audio kasetave – dhe mësimi i lojërave mund ta rrisë të mësuarit, ose me adaptimin e lojërave tradicionale ose me zbulimin e të rejave.

Ka lloje të ndryshme të nxënësve në të gjitha klasët por në klasën speciale grupi është veçanërisht i shumëllojshëm. Nxënësit jo gjithmonë mund t’i përdorin materialet e njëjta për shkak të aftësive të tyre dalluese. Mësimi nuk mund të përfundojë lehtë nëse temat janë shumë të vështira. Nëse detyrat janë shumë të lehta, nxënësit nuk do të kenë rast të përmirësohen. Prandaj, materiali duhet të jetë i një niveli optimal të vështirësisë. Nxënësi mund të mësojë më lehtë nëse ai ose ajo është aktiv dhe i bën gjërat në mënyrë të pavarur. Mësimdhënësi mund të rrisë të mësuarit duke përdorur materiale që i stimulojnë të pesë shqisat sa më shumë që të jetë e mundur. Shembujt e mëposhtëm tregojnë se si materialet për mësimdhënie mund t’i ndihmojnë fëmijës për të mësuar:

Kaltrina nuk i kupton konceptet numerike, madje as për numrat nën dhjetë, pra ajo nuk mund të bëjë ndonjë veprim matematikor, pa marrë parasysh sa i thjeshtë. Sipas planprogramit, mësimdhënësi duhet të mësojë probleme të komplikuar si shumën me tri shifra. Mësimdhënësi vëren se kjo nuk e rrit mësimin e Kaltrinë, sepse ajo duhet të ushtrojë në koncepte më të thjeshta më parë. Mësimdhënësi atëherë jep materiale që janë më të lehta për të, libra pune që të bëjë gjërat vetë, në të njëjtën kohë kur nxënësit tjerë bëjnë ushtrimet më të komplikuar.

Në një shembull tjetër, gjatë mësimin për mollët, mësimdhënësi dëshiron që studentët të kenë përvojë më konkrete, duke treguar aspekte të ndryshme të temës. Së pari, mësimdhënësi dhe nxënësit flasin bashkë për mollat, qfarë produkte mund të bëhen e kështu me radhë. Pastaj

nxënësit e këndojnë një këngë për mollarat. Mësimdhënësi e sjell një mollë në klasë ashtu që nxënësit mund ta prekin atë, ta ndejnë dhe ta shijojnë. Ditën tjetër, nxënësit do të kenë një ekskursion te një vend afër shkollës që ta shohin një trung molle.

Grupi i Ekspertëve Kosovar mbi Arsimin Special ka përshkruar materialet e mira të krijuara ose mbledhura nga mësimdhënësit. Materiali i mirë mësimdhënës është motivues, praktik, relevant, i ndryshëm dhe plotëson nevojat e vërteta të nxënësit.

Njëri qëllim i arsimit special është të sigurojë një arsim që e bën nxënësin të pavarur aq sa të jetë e mundur. Shpesh prindërit dhe mësimdhënësit e asistojnë nxënësin në shumë mënyra, ndonëse nxënësi mund të mësojë vetë gjithashtu. Është shumë me rëndësi për fëmijët të mësojnë aftësi që nevojiten për jetën e përditshme, si blerja dhe përgatitja e ushqimit dhe pastrimi. Ndonëse mund të mos ketë material për këtë qëllim, mësimdhënësi duhet të përdorë objekte të ndryshme për të ilustruar dhe qartësuar aktivitetet. Për shembull, mësimdhënësi mund ta mësojë nxënësin të blejë diqka në shitore duke përdorur produkte të ndryshme, marrjen e parave dhe kthimin e kusurit, me qëllim që ta bëjë çështjen më konkrete për nxënësin dhe të mësojë për paratë.

Qëllimi 8: Informimi i publikut për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin arsimor

Institucionet arsimore duhet ta informojnë publikun për aktivitetet e tyre dhe MASHT duhet të zhvillojë dhe implementojë një plan për t'ua komunikuar reformat e arsimit special në Kosovë publikut gjeneral. Informimi në media – në programe televizive apo në radio ose në gazeta mund t'i eliminojë paragjykimet ndaj njerëzve me nevoja të veçanta. Gazetarët mund të prezantojnë raporte në kontekst të fëmijëve me nevoja speciale, duke rritur informimin dhe duke zhvilluar diskutime publike. Një numër i konsiderueshëm i njerëzve përfshirë edukatorët, e shohin arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta si shumë të rëndësishëm por ata ende mendojnë vetëm për institucione si shkollat speciale. Rritjen e informimit publik, madje edhe në komunitetin profesional, për zhvillimet e reja në fushën e fëmijëve me nevoja të veçanta përfshirë një varg të gjërë të strategjive për përkrahje sociale dhe intelektuale dhe zhvillim nëse është e domosdoshme. Këto përpjekje mund të përfshijnë Sektorin e Informimit dhe departmentin e Marrëdhënieve me Publikun për të punuar me punëtorët e arsimit special në Ministrinë e Arsimit për të informuar mediat për zhvillimet në këtë fushë.

Tërë personelit të MASHT-it, drejtorëve komunal të arsimit dhe zyrtarëve të lartë duhet t'u ofrohet një mundësi të marrin pjesë në seminarin një ditë për mendimin kritik dhe qasjet e reja në arsim për fëmijët me nevoja të veçanta. MASHT dhe OJQ-të duhet të publikojnë pamflete për nevojat dhe të drejtat e fëmijëve (posaçërisht të atyre me nevoja të veçanta) për t'ua dërguar prindërve, grupeve të grave edhe qendrave të mjekësisë familjare – nesë është e mundur me përkrahjen e organizatave që promovojnë të drejtat e fëmijëve. Këto pamflete duhet të spjegojnë se si prindërit dhe mësimdhënësit mund t'i mbështesin nevojat e fëmijëve të paaftë, përfshirë thjeshtë duke folur me ta, duke i dëgjuar telashet e tyre, duke bërë lojëra kreative të mundshme dhe duke lexuar libra për fëmijë. MASHT dhe OJQ-të duhet poashtu të zhvillojnë materiale mbi të drejtat e fëmijëve dhe rrugëve alternative të menaxhimit të sjelljes problematike.

Rekomandimet

Qëllimi i përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt do të ballafaqohet me pengesa të ndryshme sociale, politike, ekonomike dhe institucionale në Kosovë. Ndërrimi i udhëheqësisë së politikave çdo tri apo katër vjet si edhe statusi politik i padefinuar i Kosovës do të vazhdojnë të ndikojnë në reformat e sistemit arsimor, posaçërisht gjatë unifikimit të sistemit arsimor dhe për përfshirjen e nxënësve me nevoja speciale. Në të gjitha demokracitë, ndërrimet në qeveri pas zgjedhjeve ose ndryshe mund gjithashtu të rezultojnë me ndryshime në politika. Integrimi i sistemit arsimor dhe implementimi i

kornizës ligjore nëpër tërë Kosovën është i mbështetur mbi zhvillime të caktuara të politikave. Bazuar në përvojat e vendeve tjera të Evropës Lindore dhe Qëndrore, mënyra më e mirë për të tejkaluar pavazhdimësinë, në politikën arsimore është politika përfshirëse në të cilën të gjitha palët e përfshira kontribuojnë në procesin e reformave dhe e shohin veten si person kyç në reforma. Kjo përfshin depolitizimin e politikës arsimore me qëllim të fokusimit të energjisë në arritjen e efektit maksimal në mjete publike dhe jo kryerjen e qelimeve specifike personale ose politike. Me qëllim të përfshirjes së informatave më të mëdha, është i nevojshëm një plan komunikues për t'ua shpjeguar procesin e arsimit përfshirës palëve të ndryshme. Një plan stabil implementues, i monitoruar nga donatorët, me një fokus të qartë dhe mekanizma për vlerësim poashtu do të ndihmojë në sigurimin e koherencës dhe konsistencës.

Pengesa më e rëndësishme që mund të çojë në bërjen e programeve të pambrojtura mund të jetë rritja e dobët ekonomike në Kosovë, detyrimet buxhetore në Ministrinë e Arsimit, të ardhurat e vogla për mësimdhënësit dhe buxhetet e ulta në familje. Përvojat e vendeve të Evropës Lindore dhe Qëndrore tregojnë se privatizimi në ekonomi rezulton me nevoja të mëdha të shoqërisë në fazat e hershme. Mekanizmat që do të mund të balanconin influencat e mundshme të faktorëve ekonomik përfshijnë një plan strategjik fleksibil që do të përshtatë ndryshimet në zhvillimet e arsimit, aprovimin e alternativave rezervë në rast të vështirësive buxhetore, ofrues alternativ të arsimit siç është arsimit privat, qasje kreative dhe praktike në hartimin e programeve për trajnime të mësimdhënësve, organizim më të mirë dhe sistem më racional (duke respektuar, sipas mundësive, proporcionin 22 nxënës për një arsimtar), kursimet financiare përmes efikasitetit në sistemin arsimor, rritjen e orëve punuese në javë (mësimdhënësit mund të punojnë 26 orë në javë me nxënës dhe poashtu do të kishin mjaft kohë për të përgatitur orët), inkurajimin e donacioneve dhe investimi lokal dhe ndërkombëtar.

Reforma arsimore duhet të jetë e menajuar mirë për të arritur kredibilitet dhe për të arritur objektivat. Mungesa e përvojës në administratë mund të ngadalësojë procesin e zhvillimit të ndonjë plani strategjik. Shkollat dhe klasët e bashkangjitura që janë ndërtuar ose riparuar duhet të mirëmbahen dhe pajisen. Procesi i zhvillimit të programeve mësimdhënëse në koordinim me sektorin e planprogramit në MASHT duhet të vazhdohet sipas planit strategjik dhe programeve të ndryshme për trajnim të mësimdhënësve (duke filluar me FSDEK) duhet të shtohen dhe të mbahen me qëllim të zhvillimit të burimeve njerëzore. Mirëpo, shpesh ndodh që shkollat janë ndërtuar por nuk janë të mirëmbajtura ose pajisura mirë, ose projektet nuk janë zhvilluar duke marrë parasysh problemet e parashikuara. Kjo prezanton pengesa serioze në qëndrueshmërinë e projektit. Prandaj, është e domosdoshme të ketë një plan të ndërgjegjshëm për zhvillimin e procedurave administrative përfshirë planifikimin e politikave, buxhetimin, monitorimin dhe vlerësimin, komunikimin, konstruktimin dhe mirë mbajtjen e objekteve, krijimin e bazës së të dhënave dhe analizat, zhvillimin e planprogramit dhe kërkimeve dhe trajnimit e vazhdueshëm të personelit arsimor. Është shumë me rëndësi që rezultatet të përfshijnë orare specifike ashtu që aktivitetet kryhen sipas planit. Koha e implementimit do të vendoset sipas volumit të punës që ka për t'u bërë, që ka nevojë të jetë e vlerësuar në mënyrë të duhur me qëllim që të arrihen rezultate cilësore.

Një faktor tjetër i rëndësishëm në zhvillimin dhe implementimin e planit strategjik është përgatitja e fondeve të domosdoshme për të financuar realizimin e programit dhe projekteve relevante në sistemin arsimor. Sistemi arsimor në Kosovë është në prag të reformave për të riparuar dëmet nga Luftërat Botërore dhe konfliktet tjera. Në anën tjetër, ekonomia dhe buxheti i Kosovës ka mundësi të limituara për t'i përmbushur nevojat buxhetore për MASHT-in. Bazuar në këto fakte, MASHT, në bashkëpunim me strukturat tjera të qeverisë, duhet të bëjë përpjekje të gjejë fonde alternative përmes donatorëve lokalë dhe ndërkombëtarë. Në vitet 2002-2007, MASHT ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë për këtë qëllim me donatorët në projekte konkrete për zhvillimin e sistemit arsimor.

KONKLUDIMI

Kosova ka vendosur në vende të veta një mori elementesh të domosdoshme për të krijuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës në të ardhmen. Këto përfshijnë trajnime të mësimdhënësve përmes kurseve TESFA, klasë të bashkangjitura përgjatë gjithë vendit, zhvillimin e modeleve të qendrave burimore dhe disa mbledhje të të dhënave. Politikat dhe korniza ligjore ashtu si edhe kornizat institucionale dhe administrive ende duhet të zhvillohen, siç duhen burimet e fondeve stabile dhe angazhimi për arsimin special në shkollat e rregullta. Plani strategjik i cekur më lart është një vegël që do të asistojë në organizimin e këtyre përpjekjeve në të ardhmen e afërt. Mirëpo, siç u cekë më lart, ambientet ekonomike dhe politike të Kosovës gjithashtu kanë një ndikim të rëndësishëm në këtë proces. Shpresohet se stabiliteti dhe mirëqenia e vazhdueshme do të ndihmojë në themelimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të arsimit special në të ardhmen, që siç ka treguar ky raport është e mundur.

Rast studimi 1 : Një vajzë 8-vjeçare me sindromin e Daunit në Prizren

Kariera arsimore e nxënësit

Nxënësja, “D”, ka dëmtime intelektuale. Prindërit e saj, së bashku me njësinë për arsim special brenda komunës (përfshirë një mësimdhënës nga shkolla speciale dhe qendra burimore *Lef Nosi* për fëmijët me dëmtime intelektuale) vendosen që ajo duhet të vijojë mësimin në klasët e bashkangjitura në shkollën e rregullt aer shtëpisë së saj. Klasa është shumë e larmishme – nxënësit tjerë kanë vështirësi në mësim dhe dy nga ta kanë dëmtime në të dëgjuar. D-ja ka mësuar të lexojë dhe shkruajë, ndonëse leximi i saj është vështirë të interpretohet. Ajo është shumë paqësore dhe e qetë në klasë.

Kushtet përkrahëse

Përkrahje është e siguruar bazuar në ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm dhe normave tjera të lëshuara nga MASHTI. Komuna e Prizrenit ka formuar një grup përkrahës për arsimin special në bashkëpunim me shkollën *Lef Nosi*, e cila formon bazën për mbështetje në këtë fushë. Përmes monitorimit, përkrahjes dhe këshillave, grupi përkrahës përmirëson procesin mësimor në klasë. Mësimdhënësi i klasës do të ketë gjithashtu trajnim gjatë punës.

Përkrahja e siguruar

Mësimdhënësi i klasës do të pranojë përkrahje javore nga mësimdhënësi i lëvizshëm nga shkolla *Lef Nosi*. Një PIA është përgatitur për nxënësen D dhe për të gjithë nxënësit tjerë. Planprogrami është adaptuar për t’i mësuar nxënësit në të gjitha lëndët. Aftësi akademike, aktivitete ditore dhe aftësi sociale janë pjesë e asaj që shkolla ofron. Dita e mësimin riorganizohet në bashkëpunim me personelin nga qendra buimore e arsimit special, ashtu që nxënësit do të ketë fleksibilitet bazuar në detyrat që janë bërë gjatë ditës. Ata nuk do të limitohen saktësisht në 45 minuta për orë. Çdo vit, ata kryejnë projekte speciale duke integruar të gjitha lëndët në bashkëpunim me ata që janë trajnuar nga FSDEK për arsimin profesional (zhvillimi profesional) nga Universiteti i Prishtinës. Mësimdhënësit janë poashtu të regjistruar në programe trajnimi të TEFSA-së për të rritur nivelin e tyre të aftësive dhe për të pasur mundësi që të marrin pjesë në rrjetin e mësimdhënësve për nevoja të veçanta. Trajnerët e TESFA-së janë gjithashtu të regjistruar në vlerësimin cilësor për punën në klasë. Ekipi i klasës poashtu ofron mbështetje për familjen dhe shkollën.

Komentet

D –ja ka pasur disa lëndë shkollore dhe i kanë pëlqyer. Ajo ka pasur zë shumë të mirë, ndjenjë të mirë të ritmit dhe talent për vizatim. Ata propozuan që ajo mund të integrohej në klasët e rregullta në muzikë

dhe art të vitit të ardhshëm. Kjo do ta rriste informimin e saj social (ajo nuk është gjithmonë në disponim të mirë dhe ka pasur vështirësi në pritjen në radhë për diskutim). D-ja nuk është planifikuar të ndjekë secilën shkollë dhe lëndë. Vitin tjetër, ajo do të integrohet në disa lëndë derisa aftësitë e saj të përmirësohen. Kur ajo të jetë gati për të hyrë në shkollën *Lef Nosi*, ajo poashtu do të shkojë në qendrën burimore dhe të kalojë nëpër trajnim profesional që do t'i ndihmojë asaj në shkollën e saj profesionale.

Rast Studimi Dy: Djalë 12-vjeçar më dëmtime në të parë në Pejë

“S” ka dëmtime në të parë, që është zbuluar në fëmijërinë e tij të hershme dhe rezulton nga çrregullimi *makular*. Në fillim S-ja ka vijuar shkollën për fëmijë me dëmtime në të parë *Xheladin Deda* në Pejë, kur ai ishte shtatë vjeçar. Shkolla morri pjesë në pilot projektin për arsimin gjithëpërfshirës dhe S ishte në mesin e dhjetë nxënësve me aftësitë më të mira që ishin selektuar për projektin. Atëherë ai është dërguar në një shkollë me klasë të bashkangjitura afër shtëpisë së tij dhe tani është në klasë të rregullt së bashku me shokët e tij. Mësimdhënësit e klasëve të bashkangjitura, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit e klasëve të rregullta kanë marrë pjesë në trajnimin special të TEFSA-s për dëmtime në të parë. Gjatë modulit të paaftësive në të parë nga trajnimi profesional dhe zhvillimi i ofruar nga Universiteti i Prishtinës, ata i dhanë atij disa orë mësimi në Braillë dhe në përdorimin e numrave në qendrën burimore *Xheladin Deda*. Kjo ishte pranuar nga njësia e arsimit special në komunën e Pejës.

Kushtet përkrahëse

MASHT, së bashku me komunën e Pejës dhe shkollën *Xheladin Deda*, e pranuan idenë e pilot projektit. Janë siguruar fonde për aktivitete të mësimdhënësve shëtitës, trajnimin e mësimdhënësve dhe për disa modifikime në gjendjen fizikë të shkollës siç është ndriçimi i mirë.

Përkrahja e siguruar

Qendra burimore siguroi llamba për punë dhe CCTV për nxënësit – të njëjtat që përdoren në shkollat speciale. Mësimdhënësit e klasëve të bashkangjitura dhe mësimdhënësit e klasëve të rregullta formuan një ekip në shkollë. Së bashku me mësimdhënësin shëtitës, ata përgatiten një PIA për S-në. Meqenëse ai është mjaft inteligjent, nuk kishte nevojë për adaptim të planprogramit. Fokusimi kryesor ishte në vendosjen e metodave të caktuara të mësimdhënies. Mësimdhënësi shëtitës poashtu i viziton nxënësit. Gjendja vizuale e S-së është fatkeqësisht çdo ditë e më e dobët. Në të ardhmen ai do të duhet të njohë Braillin dhe të udhëtojë i pavarur. Ekipi është duke diskutuar këto çështje me S-në dhe familjen e tij. Ata momentalisht kanë vështirësi të pranojnë se ai mund të jetë totalisht i verbër në të ardhmen.

Komentet

S ka mundësinë të finalizojë kërkesat e arsimit gjithëpërfshirës. Me mbështetje dhe teknika mësimi të duhura ai do të jetë i aftë të shkojë në të njëjtat kurse si shokët e tij. Ai është i njohur dhe pranuar mirë në mes të shokëve të tij. Është e vështirë në këtë fazë të parashikohet profesioni i tij në të ardhme.

RAPORTI I SINTEZËS

Raporti i Ndërkombëtar i Sintezës krahason raportet e vendeve të Bosnes dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Kosovës, IRF të Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Serbisë përgjatë këtyre vijave: kornizave ligjore ekzistuese, fushën e zhvillimit të politikave, statistikat dhe indikatorët, trajnimet e mësimeve, përfshirjen e prindërve, konceptet pedagogjike, zhvillimin e planprogrameve dhe organizimin shkollor. Ai nënvizon se sistemet arsimore të analizuar vetëm kohëve të fundit kanë filluar t'i kushtojnë vëmendje të plotë arsimit të fëmijëve me nevojë të veçanta dhe konceptit të arsimit gjithëpërfshirës. Pa dyshim, dokumentet ndërkombëtare politike siç janë Konventa e KB mbi të Drejtat e Fëmijës ose Korniza për Veprim e Forumit Botërorë të Arsimit në Dakar kanë luajtur rol kritik në identifikimin dhe implementimin e politikave reformuese në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës. Ndonëse një numër i vendeve ndajnë sfond të përbashkët historik dhe politik, burimet, fusha dhe metodat për t'ua përshtatur praktikën arsimore nxënësve me nevojë të veçanta ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend. Megjithatë, disa probleme ende mbesin të krahasueshme, siç janë mungesa e të dhënave të besueshme statistikore ose mungesa e informimit të publikut për shqetësimet e arsimit gjithëpërfshirës.

Hyrje

Të gjitha vendet pjesëmarrëse në projekt përfshijnë arsimimin e “fëmijëve me nevoja të veçanta” si pjesë e sistemeve të tyre nacionale, megjithëse ka qasje dhe politika të ndryshme të zgjedhura nga qeveritë individuale dhe ministritë e arsimit. Që nga ndryshimet politike në rajon në vitet e hershme të 90-ave, sistemet nacionale arsimore kanë bërë reforma të gjëra dhe secili vend ka zhvilluar një strategji me politika për të implementuar ndryshimet.

Në disa vende, (për shembull Bullgari dhe Kosovë) implementimi i arsimit gjithëpërfshirës është prioritet konkret i qeverisë dhe kjo është pjesë e ligjit arsimor nacional; Kroacia gjithashtu u jep prioritet fëmijëve me nevoja të veçanta. Në IRJ të Maqedonise, reforma e vazhdueshme arsimore synon për integrimin social të të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta, përfshirë fëmijët me vështirësi në mësim e poashtu edhe fëmijët e talentuar. Në Moldavi, sistemi ekzistues arsimor mbulon arsimin për fëmijët me nevoja të veçanta ashtu që ofron trajnime speciale për ta por qeveria përpiqet për integrimin social të fëmijëve me vështirësi – i njëjti qëllim ndahet edhe nga qeveria e Malit të Zi, ku reforma e vazhdueshme arsimore tenton të krijojë kushte për të siguruar integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt. Në Rumani, arsimi special është pjesë e sistemit arsimor nacional. Në Serbi, statusi i arsimit special dhe shkollave speciale nuk është i rregulluar qartë përbrenda sistemit arsimor, por një grup ekspertësh për arsimin special është themeluar nga Ministria e Arsimit, i cili ka përgatitur analizën e situatës së tanishme dhe ka bërë propozimet për reformat në këtë sektor.

Në të gjitha vendet, ka një komision, organ apo institucion ekspert zyrtar që merret me klasifikimin e fëmijëve me vështirësi, dhe vendosin për regjistrimin e tyre në shkollat speciale ose në sistemin e rregullt shkollor. Prindërit zakonisht janë të përfshirë në këtë proces të vendimit.

Procesi i integritit të fëmijëve me çfarëdo lloj të vështirësive, paaftësive apo nevojave të veçanta në arsimin e rregullt është në zbatim e sipër në të gjitha vendet; madje edhe në ato vende që nuk e kanë ende arsimin gjithëpërfshirës si qëllim në legjislacionin ose politikat e tyre.

Në të gjitha vendet, arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta është i organizuar përmes:

- Shkollave speciale;
- Klasëve speciale në shkollat e rregullta;
- Integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasët e rregullta.

Dallimi në këto vende është shkalla (nga ajo e lehta deri te shkalla e rëndë e vështirësisë) dhe numri i fëmijëve që integrohen në arsimin e rregullt. Në Bullgari, gjithnjë e më shumë nxënës po integrohen në shkollat e rregullta, por atje ka shkolla speciale për kategori të tjera të paaftësive; në Kosovë vetëm një numër i vogël i fëmijëve me “paaftësi të ndryshme” është integruar në shkollat e rregullta; në Kroaci “një pjesë” e fëmijëve me “vështirësi në zhvillim” arsimohen në grupe dhe klasa speciale në shkollat e rregullta filllore; në IRJ të Maqedonisë arsimi fillor është i organizuar brenda rrjetit të institucioneve speciale dhe në klasa të rregullta dhe speciale në shkolla të rregullta; në Moldavi fëmijët me probleme dhe vështirësi të rënda transferohen në institucione speciale të drejtuara nga Ministria e Punës, megjithatë janë bërë disa pilot programe për gjithëpërfshirjen. Gjithashtu ka institucione speciale për fëmijët e keqtrajtuar, jetimët dhe fëmijët me probleme psikologjike. Në Malin e Zi, ka një rrjet të institucioneve për “fëmijët me vështirësi në zhvillim”. Ka gjithashtu disa shkolla gjithëpërfshirëse dhe klasë speciale në shkolla të rregullta. Në Rumani, varësisht nga shkalla e paaftësisë së tyre (e mesme apo e rëndë), fëmijët regjistrohen në shkollat speciale. Fëmijët me mungesa të vogla, vështirësi në mësim dhe probleme në sjellje etj. janë të integruar në shkollat e rregullta ku atyre u ofrohet përkrahje speciale. Në Serbi, arsimi për fëmijët me

nevoja të veçanta është i organizuar në shkolla speciale për fëmijë, klasëve speciale në shkollat e rregullta dhe klasëve të rregullta në shkollat e rregullta me disa nxënës me vështirësi/nevoja të veçanta. Në Bosne dhe Hercegovinë, arsimit i shumicës së fëmijëve me nevoja të veçanta ende vazhdon në shkollat speciale ose në klasë speciale brenda shkollave të rregullta; megjithatë, sot po bëhen përpjekje për të shkuar drejt një sistemi të integruar arsimor që i vlerëson të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë.

Niveli dhe tipi i perkrahjes speciale që fëmijët e marrin në shkollat e rregullta ose speciale poashtu ndryshon nga vendi në vend, siç ndryshon edhe niveli dhe tipi i trajnimit të arsimtarëve dhe personelit tjetër, si dhe disponueshmëria e burimeve tjera dhe paisjeve të shkollave dhe institucioneve.

Një varg i gjërë i interpretimeve të “arsimit special” mund të gjindet në të gjitha vendet. Për t’i përshkruar “fëmijët me nevoja të veçanta”, terminologji e ndryshme përdoret brenda sistemeve arsimore përkatëse. Raportet flasin për “paaftësi, vështirësi, çrregullime, mungesa dhe pengesa në zhvillim etj.” dhe nuk është gjithnjë e qartë nëse këta fëmijë janë në rrezik ose kanë nevoja të veçanta si mentale, fizike, psikologjike shëndetësore ose probleme sociale. Kjo rezulton, pjesërisht, nga aplikimi i modelit të “defektologjisë” (që daton nga koha para ndryshimeve politike në rajon) ose nga klasifikimi i orientuar kah mjekësia që aplikohet ende. Një tabelë që i klasifikon sistemet nacionale të kategorive sipas vendit është dhënë në Shtojcën 1.

Në disa vite të fundit, gati të gjitha vendet kanë filluar gjithnjë e me shumë të marrin parasysh fëmijët që e lëshojnë shkollën, fëmijët e minoriteteve, fëmijët nga sfondet e pafavorshme dhe fëmijët me probleme sociale si “fëmijë në rrezik”. Një shembull të zgjerimit të definimit të fëmijëve me nevoja të veçanta përfshin IRJ të Maqedonisë, e cila ka ndërmend ta zëvendësoj shprehjen “vështirësi fizike dhe psikologjike” me “nevoja speciale” dhe përfshinë një kontekst më të gjërë social në këtë definicion. Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Bullgaria, Moldavia dhe Serbia poashtu shprehin njohuri se varfëria, situata ekonomike, ambienti i dobët i jetesës dhe fëmijët pa prindër, etj. duhet të përfshihen në kategorinë e “fëmijëve me nevoja të veçanta”.

Korniza ligjore

Të gjitha vendet anëtare të KB në studim kanë ratifikuar Konventen e KB mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) (të gjitha përveç Kosovës). Të gjitha vendet i referohen dokumenteve ndërkombëtare përfshirë KDF, Deklaratën e Salamancës dhe Kornizën për Veprim të Forumit Botëror të Arsimit në Dakar (1994) dhe Kornizën për Veprim të Forumit Botëror të Arsimit në Dakar (2000) në strategjitë e tyre përkatëse dhe letrave politike.

Të gjitha vendet kane kaluar nëpër ndryshime legjislative lidhur me arsimin që nga ndryshimet politike me 1989 dhe më vonë. Qeveritë janë të vetëdijshme për domosdoshmërinë e reformave të arsimit në vendet e tyre dhe ato kanë ndërmarrë hapa të gjigant deri më tani drejt arsimit për të gjithë dhe drejt “standardeve Evropiane” në arsim.

Te gjitha vendet janë të perkrahura në përpjekjet e tyre për reformat e arsimit nga komuniteti ndërkombëtarë, posaçërisht përbrenda kornizës së Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug Lindore të vitit 1999, që ka për qëllim t’i mbështesë vendet e rajonit “në përpjekjet e tyre për të ushqyer paqen, demokracinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe prosperitetin ekonomik për të arritur stabilitet në tërë rajonin”. Ministrat e Arsimit dhe Arsimit të Lartë poashtu nënshkruan një Memorandum të Mirëkuptimit më 2003/04 në të cilin ata e angazhojnë veten për bashkëpunim në lidhje me “Programin e Detajizuar Punues mbi Vazhdimin e Objektivave të Arsimit dhe Sistemeve Trajnuese në Evropë” të BE-së. Ministrat nënshkruan poashtu cekën se “Zgjerimi i qasjes në arsimin cilësor dhe sigurimi i mundësive të barabarta – duke marrë parasysh barazinë gjinore – për minoritetet e vendit, posaçërisht të komunitetit të Romëve, dhe grupeve tjera të pafavorshme përfshirë anëtarët e grupit me të ardhura të vogla, njerëzit me paaftësi,

qytetarët nga komunitetet e izoluara rurale, etj.” po bëhet një fushë prioritare për zhvillimin dhe reformat e arsimit.

Në të gjitha vendet, Ministria e Arsimit është përgjegjëse për arsimin. Në disa vende, kjo detyrë, sidomos çështja e arsimit special, është e ndarë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë për Çështje Sociale dhe Ministrinë e Punës. Veç kësaj, në Bosnie dhe Hercegovinë, ndarja në entitete dhe kantone ka çuar në dallimin e standardeve arsimore dhe karakteristikave individuale të politikës arsimore.

Në kursin e ndryshimeve legjislative në lidhje me arsimin, gati të gjitha vendet fokusohen në një mënyrë apo tjetër në “arsimin special”. Për shembull, Bullgaria ka pranuar Aktin e Arsimit Publik më 2002, të përcjellur nga disa amandamente të fokusuar në arsimin special. Në Kroaci, arsimit i fëmijëve me nevoja të veçanta është i rregulluar nga disa ligje në lidhje me segmente të ndryshme të arsimit. Për shembull, *Akti i Arsimit Para-Shkollor* u jep prioritet fëmijëve me nevoja të veçanta, por në të njëjten kohë, është përmendur se kjo nuk është e përkrahur mjaftueshëm për shkak të buxhetit dhe problemeve të burimeve tjera. Në Kosovë, *Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm* siguron arsim për të gjithë fëmijët. Nuk ka ligj të posaçëm për fëmijët me nevoja të veçanta, por në planin strategjik për zhvillimin e arsimit është rekomanduar që të zhvillohet një politikë për arsimin për fëmijët me nevoja të veçanta.

Në IRJ të Maqedonisë, *Ligji për Arsimin Elementar* mbulon obligimet për të siguruar arsim për fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët me vështirësi në mësim dhe për nxënësit më prirje. Ligji përfshinë disa nene mbi grupe të ndryshme të fëmijëve më vështirësi, paaftësi dhe nevoja të veçanta. Në Moldavi, “Ligji i Arsimit” mbulon arsimin special, dhe në “Strategjinë Nacionale të Arsimit për të Gjithë” arsimit special është njëri nga tri prioritetet. Kantone të ndryshme përgjatë Bosnës dhe Hercegovinës ende kane shumë ligje të vjetëruara në praktikë. Megjithatë, ligji i ri i Përgjithshëm mbi Arsimin Elementar dhe Sekondar nga viti 2003 thekson se shkollat e rregullta fillore duhet të mësojnë fëmijët me vështirësi në klasat e rregullta.

Serbia gjithashtu ka ratifikuar dokumentet ndërkombëtare mbi arsimin dhe të drejtat e fëmijëve. Në “Ligjin mbi Arsimin e Shkollave Fillore”, nuk ka asnjë adresim për fëmijët me nevoja të veçanta por në një amandament nga viti 2002 fëmijët me “probleme të zhvillimit” janë përmendur dhe ligji poashtu definoi procedurën sipas së cilës fëmijët klasifikohen. Në “Ligjin mbi Bazat e Sistemit Arsimor” nga viti 2003, parimet dhe objektivat gjenerale të arsimit janë definuar në mënyrë të re, dhe për herë të parë ligji flet për “rezultat të arsimit” që do të mund të kenë ndikim afat-gjatë në arsimin special.

Pasqyre e politikës duke u fokusuar në grupet speciale

Si janë të definuara nevojat e veçanta?

Jo befasisht, sfondi i dhënë në defektologji në vendet e Evropës Jug-lindore, për pjesën më të madhe, fëmijët me nevoja të veçanta janë të definuar në bazë të kategorive të paaftësive (shih Shtojcën 1), shumë nga ta duke iu referuar termeve të përdorura në defektologji. Megjithatë, në shumë vende, reformat e kohëve të fundit kanë zgjeruar konceptin për të përfshirë minoritetet etnike dhe fëmijët me prirje në disa raste. Serbia është shembull i qartë ku koncepti “fëmijët që u nevojitet ndihmë speciale sociale” mbulon këtë varg të gjërë të fëmijëve dhe është i privilegjuar tek “arsimi special”. Ky definicion reflekton nga afër atë të vendeve të OECD-së në përgjithësi.

Dallimet kryesore në mes të arsimit të rregullt dhe special janë të dukshme, natyrisht, në kuptimin e vendosjes (*p.sh.* për pjesën më të madhe, fëmijët me paaftësi arsimohen në shkollat speciale) por poashtu edhe në kuptimin e nevojës për të individualizuar mësimdhënien për t’i përmbushur nevojat e nxënësit. Ndryshimet në madhësinë e klasëve janë poashtu gjerësisht të pranuar si të rëndësishme. Shkollat speciale zakonisht kanë pasur proporcion me të favorshëm mësimdhënës-nxënës dhe në shkollat e rregullta,

madhësitë e klasëve janë zvogëluar nëse kanë përfshirë nxënës me paaftësi. Në nivelin e mesëm, ka tendencë për nxënësit e arsimit special të trajnohen në shkolla profesionale me qëllim të qartë të punësimit e jo të mendohet për ta si kandidatë për arsimin e lartë, ndonëse raporti i një vendi e ka bërë të qartë se nxënësi me paaftësi me diplomë do të mund të ishte në gjendje të qaset në nivelin e tretë të arsimit. Përndryshe, nuk kishte ndonjë lidhje në mes të shkollave të rregullta dhe speciale.

Si janë të kuptuara dhe definuara konceptet e integritit dhe gjithëpërfshirjes? Si mund të implementohet gjithëpërfshirja?

Si në gati të gjitha vendet e OECD-së, shkollat speciale, klasët speciale dhe klasët e rregullta gjinden në të gjitha vendet e Evropës Jug-lindore. Shkurtimisht, shumë shkolla janë institucionale dhe rezidenciale. Duke përcjellur marrëveshjet ndërkombëtare (*p.sh.* Salamanka dhe karta e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës), shumica e vendeve kanë dhënë vëmendje të konsiderueshme drejt zhvillimit të gjithëpërfshirjes. Kuptimi i konceptit të gjithëpërfshirjes, në kontrast me integrimin, ndryshon gjerësisht. Në disa vende, nuk ka asnjë dallim në përdorimin e këtyre termeve. Megjithatë, për pjesën më të madhe, ato shihen si të ndryshme qartë – integrimi kuptohet si rifutja e nxënësve të arsimit special në klasë të rregullta dhe gjithëpërfshirja përfshirjen e ndryshimit të konsiderueshëm në mënyrën si funksionon shkolla ashtu që shkolla bën adaptime për t'i përmbushur nevojat e fëmijut. Kjo shpesh do të thotë që fëmijët shkojnë në shkollën e tyre lokale dhe marrin mësim individual. Vendet e dinë se kjo kërkon ndryshime të konsiderueshme në mendimin për përgatitjen e arsimit.

Rrjedh se për të implementuar gjithëpërfshirjen kërkon reforma në një numer nivelesh në sistem dhe në një varg të gjerë faktorësh. Ndryshimet në kornizën ligjore, ndryshimet në terminologji, në përgatitjen financiare, në hapësirën dhe tipin e shërbimeve që e përkrahin arsimin, në trajnimin e mësimitdhënësve – pas dhe gjate punës (INSET), në qasjen fizike në shkollë dhe në arsimin para-shkollor. Prindërit gjithashtu janë të nevojshëm të përfshihen më shumë dhe qëndrimi i mësimitdhënësve në shkollat speciale dhe shkollat e rregullta duhet të ndryshohet. Prindërit e nxënësve pa të meta poashtu nevojitet të bëhen më të pranueshëm. Veç kësaj, procedura më të mira të monitorimit nevojiten të implementohen.

Shkurtimisht, nevojitet të ketë ndryshim kultural në shumë nivele, me strategji dhe politika të reja në nivelin shkollor që duhet të implementohen në praktikë. Disa vende kanë adresuar direkt çështjet e implementimit dhe kanë parë rëndësinë e zhvillimit të intervenimit të hershëm dhe regjistrimin në arsimin para-shkollor dhe vitin e parë të shkollës fillore. Në paralele, do të mund të kishte transfer të nxënësve me paaftësi më pak të rënda nga shkollat speciale në klasa të rregullta, e cila do të kishte mbështetje. Veç kësaj, disa shkolla speciale bëhen shkolla të hapura për të gjithë fëmijët në komunitet. Mësimitdhënësit në shkollat speciale mund poashtu të ndihmojnë integrimin duke u bërë fleksibil dhe duke udhëtuar nga shkolla në shkollë. Disa mësimitdhënësve të zgjedhur nga ky grup, do të mund t'u ipej rol më i zgjeruar për të mbështetur dhe këshilluar shkollat e rregullta dhe për të zhvilluar material të specializuar.

A janë të gjithë fëmijët të edukueshëm dhe a është kjo përgjegjësi e qeverisë?

Edhe pse kjo nuk ka qenë gjithmonë e vërtetë në të kaluarën, tani, në të gjitha vendet, qeverija merr përgjegjësinë për arsimin e të gjithë nxënësve së paku deri në fund të shkollës fillore, ndonëse kjo mund të mos jetë gjithmonë ministria e arsimit. Megjithatë, meqenëse shumë nga këto ndryshime janë shumë të reja në disa vende, jo të gjithë fëmijët me paaftësi e vijnë në shkollë.

A merren parasysh nevojat e nxënësve me paaftësi dhe atyre në rrezik në të gjitha nivelet e procesit të reformave të arsimit?

Përgjigjet në këtë pyetje ishin të varfëra dhe të përziera, duke u shtrirë nga të plotat deri në pa përgjigje.

A janë burimet të konsiderueshme apo minimale?

Burimet përgjithësisht janë konsideruar të pamjaftueshme. Në shumicën e vendeve, pak, nëse ndonjë, burim shtesë i janë dhënë shkollës për arsimin e fëmijëve me paaftësi. Disa nga personeli i shkollave speciale dhe administratorët poashtu frikohen se integrimi do të thotë humbje e punës për personelin e shkollave speciale.

Cilët faktorë konsiderohen të jenë pengesa dhe lehtësime të gjithëpërfshirjes dhe paanësisë?

Lehtësime ishin reformat arsimore duke prezantuar kornizë ligjore dhe politika pozitive dhe mbështetja e autoriteteve, anagazhimi në marrëveshjet ndërkombëtare, roli i OJQ-ve, interesi i shkollës dhe fleksibiliteti, autonomia profesionale e mësimitdhënësve, trajnimi i mësimitdhënësve – sidomos INSET-i, dhe qëndrimi pozitiv i mësimitdhënësve. Lehtësime tjera janë prindërit e motivuar dhe përkushtuar, bordet e shkollave dhe organizatat e komunitetit përfshirë organizatat e shumta ndihmëse vendore dhe të huaja. Koordinimi në mes të sigurveve të shërbimeve, përfshirë shërbimet ndihmëse siç janë ato për kujdesin shëndetësorë dhe shërbimet civile, është lehtësues esencial i sistemeve arsimore të shëndetshme. Një vend identifikoi rolin e gjurmëve dhe rëndësinë e sistemit që lejon individualizimin. Planet individuale arsimore janë një tjetër lehtësim i suksesit në gjithëpërfshirje dhe barazi. Lehtësime të tjera janë mjedisi pozitiv socio-ekonomik përfshirë paisje dhe materiale të mjaftueshme në shkollë dhe klasë. Burimet tashmë prezente në shkollat speciale janë lehtësime të gjithëpërfshirjes kur shfrytëzohen në trajnime dhe asistencë për shkollat e rregullta. Përdorimi i mediave për të promovuar reformën ishte cekur në disa raporte.

Pengesat ishin të shumfishta – vetë situata ekonomike, korniza ligjore, mungesa e qartësisë në rolin e personave kyç, mungesa e dijagnozave, mungesa e arsimit para-shkollor, mungesa e cilësisë për arsimin special në shkollat e rregullta, mungesa e të dhënave, mungesa e trajnimit të mësimitdhënësve, qëndrimet negative të fëmijëve pa të meta (që çon në izolim) dhe prindërve dhe mësimitdhënësve të tyre në shkollat e rregullta, paragjykimet, debatet përtej përgjegjësisë, klasat tepër të mëdha, puna shumë kërkuese, s'ka material, burime të pamjaftueshme, qasje e limituar deri te shërbimet tjera të duhura, ngurtësia, vështirësia e përdorimit të qasjes multi-disiplinore, pandjeshmëria e sistemit gjurmues për vlerësimin e progresit individual, mësimi i lëndëve në nivelin sekondar përmes së cilit fëmijët takojnë një numër të madh të mësimitdhënësve në krahasim me një mësues klase në nivelin fillor, dhe restriksionet e moshës për qasje në arsimin fillor.

Zhvillimet e reja të politikave për nxënësit e paaftë dhe ata në rrezik

Fëmijët të cilët janë “në rrezik” janë të konsideratës në rritje përgjatë rajonit. Bullgaria synon të shumë fëmijë që e braktisin shkollën, që janë jetimë dhe, mund të jetojnë në rrugë ose munden madje të bëhen pjesë e unazave të paligjshme trafikimi. Shumë nga fëmijët që braktisin janë nga familjet e Romëve si edhe të atyre që jetojnë në varfëri. Largësia nga shkolla, izolimi social, interesimi i vogël i familjes për arsim, pedagogji jo atraktive dhe shëndeti i dobët janë të gjitha arsye të dhëna për lëshimin e shkollës. Interesant, shumë nga këta faktorë poashtu ishin identifikuar në studimin e OECD/CERI mbi fëmijët në rrezik në vendet e OECD-së. Në Moldavi, Bosne dhe Hercegovinë, Serbi, dhe disa vende tjera, qeveria gjithashtu ofron disa paisje banimi për fëmijë të tillë.

Është e qartë se ka një numër të iniciativave të reja të politikave që synojnë të përmirësojnë arsimin për keto grupe. Ligjet e reja për të drejtat e fëmijut po vendosen në vend të vet duke bërë tension, si në Serbi, në demokratizimin, decentralizimin, de-politizimin dhe vlerësimin e sistemit arsimor në kontest të ekonomisë gjenerale. Më shumë presion po vendoset mbi shkollat e rregullta për t'i pranuar të gjithë fëmijët. Nevoja për qasjen fëmija-në-qendër dhe qasjen individuale për të gjithë fëmijët është gjerësisht e pranuar nga të dyja grupet – me paaftësi (përfshirë ata me nevojat më të rënda) dhe grupit në-rrezik (siç

janë fëmijët Romë) me më shumë fleksibilitet që lejohet për këto grupe (*p.sh.* në Bullgari, nxënësit e arsimit special nuk kërkohet t'i përsërisin orët).

Ndryshimet në madhësitë e klasës po implementohen dhe trajnimi i profesionistëve përfshirë mësimdhënësit po bëhet më relevant. Disa vende kanë plane strategjike që adresojnë në mënyrë specifike faktorët socio-ekonomik dhe mungesën e përkrahjes së familjes. Trajnimi profesional poashtu po përmirësohet.

Si marrin pjesë prindërit në procesin e vendim-marrjes për fëmijun e tyre?

Rëndësia e përfshirjes së prindërve të fëmijëve me paaftësi në arsimin e tyre është shumë gjërë e pranuar nga ministratë megjithëse ndonjëherë prindërit mund të mos jenë të hapur se kanë fëmijë me paaftësi dhe në të kaluarën përfshirja e prindërve ka qenë minimale. Në shumë vende sot prindërit janë të përfshirë në qeverisjen e shkollës në nivele të ndryshme dhe madje mund të përkrahin fëmijët e tyre në klasë. Veç kësaj prindërit shpesh janë të përfshirë në vlerësimin e fëmijëve të tyre dhe mund të insistojnë që ata të mbahen në klasë të rregullta ndonëse mbështetja atje mund të mos jetë aq sa do të mund të ishte.

Si vendoset se fëmiju ka nevojë për arsim special?

Tendenca është larg nga një qasje specifike mjekësore, shpesh bazuar në principet e defektologjisë që ende ekziston në disa vende, drejt një qasjeje multi-disiplinore duke përfshirë një varg të gjerë të praktikantëve. Kritika ishte bërë nga metodat të cilat janë mbështetur në diagnostifikimin e fëmijës të bazuar në një takim të vetëm. Kjo mund të çojë në gabime serioze *p.sh.* përgjatë diagnozës së pakonsideruar të fëmijëve Romë duke çuar në vendosjen në shkollë speciale.

Kush i ndihmon nxënësit e arsimit special në shkollat e rregullta?

Në shumë vende, shkollat e rregullta kanë shërbime përkrahëse për të ndihmuar në arsimin e nxënësve me paaftësi. Në Rumani, shkollat e rregullta marrin shërbime përkrahëse përmes mësimdhënësve shetitës dhe qendrave inter-shkollore për terapine e të folurit. Klasat janë shpesh më të vogla. Në Kroaci për shembull, madhësia maksimale e klasës me një nxënës të arsimit special është 28, më dy 26 dhe me tre 24. Mësimdhënia në shtëpi sigurohet për nxënësit që sëmuren. Ka poashtu udhërrëfyes për karrierë specifike për nxënësit më të vjetër.

Në vendet tjera, ka shumë pak përkrahje profesionale. Në IRJ të Maqedonisë, njësite të lëvizshme të defektologjisë janë prezantuar në kontekst të pilot projektit, por ekspertë të tjerë poashtu mund të jenë në dispozicion. Në përgjithësi, një sasi e madhe e presionit vendoset mbi prindërit për të siguruar ndihmën shtesë për të cilën fëmiju ka nevojë.

Statistikat dhe indikatorët

Statistikat dhe indikatorët të prezantuar në raportet nacionale zbulojnë informata të pakëta për nxënësit me nevoja të veçanta në secilin vend. Shumë vende theksojnë se të dhënat ose nuk ekzistojnë ose janë shumë të limituara. Si rezultat, një analizë detale në këtë çast nuk justifikohet. Veç kësaj, ka njohuri se shumë fëmijë të arsimit special nuk e vijnë shkollën. Gjithashtu, në disa vende, këta nxënës e gjejnë veten në institute të udhëhequra nga ministri të ndryshme (*p.sh.* e arsimit, shëndetësisë, punës) dhe ky faktorë, në vetvete, nuk ndihmon në zhvillimin e bazave të të dhënave të sakta. Megjithatë, vendet e njohin rëndësinë e zhvillimit të bazave të të dhënave të plota në këtë fushë.

Aty ku llogaritjet janë në dispozicion, si në vendet e OECD-së, ka ndryshime në shifra. Proporcioni i fëmijëve me paaftësi në arsimin e detyrueshëm lëviz prej 1.7% në Bullgari deri në 4.76% në Serbi dhe Mal të Zi. Me Kroacinë (2.9%) dhe Kosovën (3.3%) në mes të këtyre dy ekstremeve. (Megjithatë, në Kroaci,

shënimet nga regjistrimi i përgjithshëm japin një vlerësim dukshëm më të vogël në përafërsisht 1.3% për nivelet 1 dhe 2 të ISCED-së. Ky vlerësim është nxjerrë nga OECD nga të dhënat e ofruara nga Kroacia).

Kroacia dhe Kosova siguruan të dhëna mbi nxënësit e arsimit special në lokacione të ndryshme. Në Kroaci, përafërsisht 66% e nxënësve të arsimit special janë në shkollat e rregullta me pjesën e mbetur që është në klasë speciale ose shkolla speciale. Fotografia në Kosovë është më komplekse për shkak të të dhënave të pakompletuara por tregohet se 90% e nxënësve të arsimit special vijon shkollat në nivelin e rregullt fillor. Bullgaria ka arsimuar një pakicë të vogël të nxënësve me paaftësi në shkollat e rregullta (0.1%). Kjo përfshinë kopshtet, shkollat dhe shkollat profesionale dhe është e paqartë për momentin se si kjo shifër lidhet me shifrën prej 1.7% të dhënë më lart për Bullgarinë. Në Serbi, përafërsisht 6% e atyre me paaftësi janë në shkollat speciale.

Të dhënat nga Rumania tregojnë se gjatë disa prej viteve të fundit numri i fëmijëve që vijojnë shkollat speciale është ulur nga 53 446 në 27 539 ndërsa i atyre në shkollat e rregullta është rritur nga 1 076 në 11 493. Thjeshtë duke mbledhur numrat së bashku për çdo vit në lokacione të ndryshme dhe duke zbritur njërin nga tjetri i lë 15 670 të pallogaritur. Ndonëse kjo shifër është llogaritje e pastër, sepse ndryshimet vjetore në listen e shkollës për të gjithë fëmijët nuk janë dhënë dhe prandaj nuk mund të llogariten, duket se disa faktorë tjerë po operojnë për të spjeguar ndryshimet e vëzhguara.

Disa hollësi të tjera ia vlen të cekem. Serbija dhe Mali i Zi ofrojnë vlerësimet e fëmijëve me probleme në dëgjim (1%) dhe probleme vizuale (0.5%) ku të dyja janë thelbësisht më të larta se të dhënat e OECD-së (dëmtime në të dëgjuar OECD-ja rradhitë nga 0.05% në 0.31%; dëmtime vizuale 0.01% deri në 0.10%).

Serbija ofroi të dhëna në dallimet në gjini të nxënësve në shkollat speciale. Në nivelin fillor – djem = 59.37% dhe vajza = 36.49%. Proporcione të ngjashme janë përmendur në Kosovë për nxënësit me paaftësi (61% djem me 39% vajza) dhe 55% djem me 45% vajza për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta. Ky përpjestim prej përafërsisht 60 deri në 40, duke qenë 3 djem për çdo 2 vajza përsëritë gati saktësisht proporcionet gjinore për këta nxënës në vendet e OECD-së.

Kroacia gjithashtu siguroi të dhëna për numrin e profesionistëve të tjerë të përfshirë në arsim për përkrahjen e nxënësve të arsimit special. Por ne nuk kemi asnjë të dhënë krahasuese për t'i vendosur këto shifra në perspektivë. Lexuesit e interesuar mund t'i gjejnë shënimet në raportin e Kroacisë. Në Kroaci, ka shtatë shkolla speciale për çdo 100 000 nxënës të shkollës fillore me një madhësi mesatare prej 114 nxënës për shkollë. Për shkollat e mesme shifrat ekuivalente janë shtatë shkolla speciale për 100 000 nxënës të mesëm me madhësi mesatare prej 87 nxënës për shkollë.

Në Bosne dhe Hercegovinë, “Duga”, një OJQ lokale bëri kërkim të gjërë që detajizon numrin e fëmijëve dhe tipin e paaftësisë përgjatë vendit.

Në të gjitha raportet, është shënuar natyra e limituar e të dhënave e cila thekson nevojën për investim të dukshëm dhe zhvillim teknik në këtë fushë.

Trajnimi i mësimdhënësve

Raportet qartë e njohin rëndësinë e trajnimit të mësimdhënësve për mësimdhënësit e fëmijëve me paaftësi dhe atyre pa të meta por ipet përshtypja se shumë nga trajnimi është teorik. Trajnimi ndryshon sipas kërkesave të ndryshme të bëra në arsimin para-shkollor, fillor dhe të mesëm. Trajnimi për nxënësit e arsimit special për mësimdhënësit e rregullt është shumë i limituar në të gjitha vendet. Trajnimi për mësimdhënësit për të punuar në shkollat speciale me lloj të posaçëm të paaftësisë është përgjithësisht në disponim, shpesh brenda kornizës së “defektologjisë”. Trajnimi për mësimdhënësit që punojnë në para-shkolla është poashtu shumë i limituar dhe nuk ekziston në disa vende.

Megjithatë, pavarësisht nga limitimet aktuale, shumë vende po planifikojnë t'i reformojnë marrëveshjet e tyre të trajnimeve në dritën e nevojave të kërkuara nga gjithëpërfshirja. Për shembull, Bullgaria dhe Rumania planifikojnë për të gjithë mësimdhënësit të marrin disa trajnime për nxënësit e arsimit special.

Një tipar veçanërisht i dukshëm është se shumë nga trajnimi gjatë punës i ofruar në këtë fushë është siguruar nga OJQ-të dhe përmes ndihmës nga jashtë. Kurset e bazuara në Universitet duket të jenë përgjithësisht të vështruara si shumë teorike.

Përpjekje të konsideruara janë qartas të nevojshme për të zhvilluar kurse trajnimi të përshtatshme dhe lehtësi lokale për të gjithë mësimdhënësit.

Trajnimi për profesionistët tjerë

Në disa vende ekzistojnë kurse për trajnimin e profesionistëve tjerë siç janë psikologët dhe terapistët e të folurit por kjo nuk është universale në rajon. Rumania drejton INSET kurse për menagjerët e shkollave dhe vlerësuesit.

Prindërit

Shumica e vendeve e njohin rolin e rëndësishëm që prindërit e luajnë në drejtimin e shkollës në nivelin e bordit shkollor por edhe në arsimin e fëmijëve të tyre me paaftësi. Disa u japin atyre qasje të gjerë në klasa ashtu që ata mund t'i përkrahin fëmijët e tyre në shkolla dhe ndonëse të tjerët janë më kufizues, rëndësia e përfshirjes së prindërve është e njohur dhe ka plane për t'i përfshirë prindërit më plotësisht në të ardhmen. Në Malin e Zi, prindërit mund të zgjedhin nëse fëmiju i tyre duhet të përfshihet në programet arsimore gjithëpërfshirëse që janë në disponim në shkollat fillore. Shumë vende, siç janë Moldavia dhe Rumania, drejtojnë kurse dhe seminare për prindërit për arsimin e fëmijëve me paaftësi.

Pedagogjia

Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në vendet e Evropës Jug-lindore ka qenë i dominuar në të kaluarën nga principet e defektologjisë e cila e inkurajon zhvillimin e kushteve të shkollave speciale. Mirëpo, kohëve më të fundit, pranimi i principeve të gjithëpërfshirjes në shkollat e rregullta ka krijuar mundësinë për rimendimin e pedagogjise për këta nxënës në pothuajse të gjitha vendet. Vështrimet e tanishme, përfshirë vendosjen e nxënësit në qendër të mësimdhënies dhe zhvillimi i planeve individuale arsimore, janë gjerësisht evidente nëse jo krejtësisht të themeluara në praktikë. Mungesa e burimeve, sidomos e burimeve njerëzore dhe materialeve të mësimdhënies, është identifikuar si limitim serioz dhe pak vende duket të kenë qasje të mirë në teknologjinë informative si burim mësimdhënies. Ndikim të posaçëm në inkurajimin e qasjes “konstruktive” ka qenë programi “Hap pas Hapi” dhe, në Kosovë, përkrahja e siguruar nga Finlanda për zhvillimin e trajnimit të mësimdhënësve për nxënësit e arsimit special. Puna e OJQ-ve tjera dhe pilot projekteve përgjatë tërë regjionit meritojnë njohje në këtë vështrim. Ndonëse këto metoda po zhvillohen për nxënësit e arsimit special, ka njohje të gjerë se ato janë gjithashtu të dobishme për nxënësit e arsimit jo-special. Në terme të përgjithshme, megjithatë, një pedagogji e ndryshme është parashikuar për nxënësit e arsimit special që është më shumë burim-intenzive dhe më e individualizuar. Është e njohur se metoda e frontit të plotë, ku mësimdhënësi është vetëm burim informacioni, nuk është gjithmonë e përshtatshme dhe aty duhet të ketë ndryshim drejt idesë së mësimdhënies si organizator i mësimin për nxënësit. Kjo mënyrë e mësimdhënies përdorë qasje më informatë-kërkuese, problem-zgjidhëse dhe të pavarur për mësimin e tyre dhe si rrjedhim angazhon fëmijën në mënyrë më kreative – duke stimuluar pavarësi në mësim, mendimin kritik etj. Këto të gjitha është menduar të jene strategji të njohura për funksionim efektiv në ekonomine e diturisë.

Të mësuarit kooperativ – ku fëmijët i ndihmojnë njëri tjetrit – është poashtu i stimuluar nga ky proces dhe inkurajon dhe konfirmon rëndësinë e punës ekipore dhe bashkëpunimit. Ofrimet e qasjeve të shumfishta për këta fëmijë, siç është spjeguar plotësisht në raportin e Kosovës, janë risi të rëndësishme për t'u ndihmuar nxënësve të arsimit special të mësojnë më me efikasitet dhe në vijë me dallimet e tyre individuale. Këto strategji e lirojnë mësimdhënësin e klasës që të përdorin disa nga koha e tyre për të kuptuar vështirësitë në mësim që nxënësit i kanë dhe ta përdorin këtë informatë në planet e mësimave të reja dhe në zhvillimin e materialeve të reja të mësimdhënies. Këto materiale duhet t'i motivojnë dhe aktivizojnë fëmijët, të bazohen në jetën reale, të rrisin sjelljen sociale, të jenë multi-shqisor (*p.sh.* u jep fëmijëve mundësi t'i përdorin të gjitha shqisat) dhe të plotësojnë nevojat e tyre specifike.

Planprogrami

Është e qartë se në të gjitha vendet ka pasur dhe vazhdon të ketë ndryshim të dukshëm në procesin e zhvillimit të planprogramit, shpesh të implementuar përmes bordeve të nevojave speciale ose byrove të themeluara kohëve të fundit. Një numër i tendencave mund të identifikohet. Së pari, kontrolli i planprogramit, që në të kaluarën ka qenë nga autoritetet qendrore, tani është i ndarë në mes të autoriteteve qendrore dhe atyre lokale dhe komuniteteve. Së dyti, ndikimi i lëvizjeve drejt arsimit gjithëpërfshirës i ka çuar vendet të shikojnë në ngjashmëritë dhe dallimet në mes të planprogramit të rregullt dhe atij special dhe të fillojnë procesin e radhitjes së tyre. Ka ende dallime të dukshme në mes të, për shembull, planprogramit në shkolla të rregullta dhe atij në shkollat speciale. Së treti, ka një përdorim të gjërë në individualizimin e planprogramit përmes, për shembull, planeve individuale arsimore (PIA-ve) dhe përdorimit të vlerësimit formues përmes monitorimit të afërt të progresit individual të nxënësit. Në Rumani, plani i shërbimit individual (PSHI) më i zgjeruar ofron grup të mbështetjes më të përgjithshëm për nxënësit e arsimit special.

Ky proces i zhvillimit të planprogramit, është i spjeguar në termet gjenerale në Kroaci në katër nivele:

1. Planprogrami gjeneral i vendosur në qendër;
2. Planprogrami ekzekutiv (plani arsimor dhe programet) me implementim lokal;
3. Planprogrami operativ i përgatitur nga një grup i mësimdhënësve ose një mësimdhënës i vetëm përgjegjës për fushën e lëndës përtej shkollës dhe;
4. Implementimi në klasë nga një mësimdhënës, që do të lejonte për individualizim.

Ka poashtu zhvillim të teksteve shkollore dhe materialeve të reja. Të gjitha këto reforma përcjellen nga pikëpamja e cekur gjerësisht dhe moderne se arsimiti nevojitet të ndryshojë ashtu që shkollat të mund t'u adaptohen nevojave të fëmijëve më parë sesa fëmijët të duhet t'u adaptohen kërkesave të shkollës.

Një tipar tjetër interesant për nxënësit e arsimit special është t'u ofrohet planprogram i orientuar më shumë në aftësim dhe punë. Do të dukej se ekziston një pikëvështrim i përgjithshëm se nxënësit e arsimit special nuk janë në gjendje të vijnë institucionet e arsimit të lartë, që padyshim nuk është rasti për të gjithë ata. Përderisa vëmendja te arsimiti për punësim është qartas e rëndësishme së madhe për të gjithë nxënësit, në të njëjtën kohë pritet për nxënësit e arsimit special nuk duhet të jenë të kufizuara.

Organizimi i shkollës

Në terme të përgjithshme, shkollat janë të organizuara centralisht dhe kanë të njëjten strukturë bazike me rregullat për planprogramin, orët e punuara, perpjestimin mësimdhënës – nxënës, etj. Në gati të gjitha vendet proporcioni mësimdhënës – nxënës është shumë më i favorshëm në shkollat speciale në krahasim me ato të rregullta. Në shumë vende, ka një varg bordesh dhe këshillash që sigurojnë përfshirjen e

personelit, prindërve dhe nxënësve në vendim-marrje në shkollë. Shkollat poashtu zakonisht punojnë me ndërrime. Për pjesën më të madhe këto shkolla nuk janë gati për qasje për nxënësit me paaftësi dhe ndonëse, në princip, sistemet do të duhej të adaptohen për nxënësit e arsimit special, në praktikë, shumë vende raportojnë se ato nuk janë. Jo vetëm që është qasja fizike problem (*p.sh.* mungesa e modifikimeve në ndërtesa) por ka gjithashtu vështirësi në fleksibilitetin e mekanizmave të fondeve dhe në qëndrimin e mësimdhënësve në shkollat e rregullta ndaj nxënësve me paaftësi.

Në Rumani, kushtet arsimore për nxënësit me paaftësi të njohura dhe komplekse janë në shkollat speciale derisa për me paaftësi fizike dhe ndijore janë në shkollat e rregullta. Veç kësaj, në atë vend sistemi i kontrollit lejon akomodim për nxënësit e arsimit special, për shembull në kuptimin e kohës shtesë, dhe poashtu prezantimin e provimeve me shkronja të mëdha ose në Braille për nxënësit më dëmtime vizuale. Keta nxënës gjithashtu mund të shkojnë në arsimin e lartë nëse i kalojnë testet e diplomës. Vendet tjera raportojnë zhvillimin e klasëve speciale në shkollat e rregullta për të ndihmuar në vendosjen e urave në hendekun në mes të paisjeve të shkollës speciale dhe gjithëpërfshirjes.

Kushtet për fëmijët me paaftësi janë kryesisht përmes shkollave speciale, ndonëse të gjitha vendet kanë politika, megjithëse në nivele të ndryshme të zhvillimit, për krijimin e gjithëpërfshirjes. Në disa vende, kushtet e shkollës speciale janë në institucione të bordit. Këto shkolla janë adaptuar për nevojat specifike të nxënësve, kanë përpjestim të favorshëm mësimdhënës – nxënës dhe janë të përkrahura nga konsultant shtesë siç janë mësimdhënësit shetitës, psikologët dhe terapistët e të folurit.

Në përgjithësi, ka mungesë të qasjes, mungesë të burimeve, qëndrime të ashpra të mësimdhënësve dhe vazhdimësia e sistemit të shkollave speciale që është në nevojë për rishikim. Në anën pozitive, shumica e vendeve raportojnë zhvillime të politikave dhe praktikave të reja drejt krijimit të arsimit gjithëpërfshirës. Qartë, ka një rrugë të gjatë për të kaluar në të gjitha këto vende.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
KAPITULLI 5 – KOSOVA.....	5
HYRJE.....	7
Sistemi i arsimit special	7
KORNIZA LIGJORE.....	8
PASQYRË E POLITIKËS FOKUSUAR NË GRUPET SPECIALE	9
Definicionet dhe kategorizimi i personave me nevoja të veçanta.....	9
Arsimi gjithëpërfshirës, paralelet e bashkangjitura dhe arsimi special në Kosovë.....	10
Implementimi i arsimit gjithëpërfshirës: roli i qendrave burimore.....	11
ORGANIZIMI I SHKOLLËS	13
Arsimi para-shkollor	13
Arsimi fillor	13
Arsimi i mesëm profesional	14
STATISTIKAT DHE INDIKATORËT	15
Nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat speciale dhe klasët e bashkangjitura	15
Fëmijët me nevoja të veçanta që vijojnë shkollat e rregullta në Kosovë.....	17
Fëmijët me nevoja të veçanta që nuk e vijojnë shkollimin në regjionin e Prishtinës	18
PLANI STRATEGJIK PËR ARSIMIN E FËMIJËVE ME PAAFTËSI.....	18
Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit për të gjithë.....	19
Qëllimi 2: Sigurimi i hapësirës shkollore që i përgjigjet nevojave të nxënësve	20
Qëllimi 3: Arritja e rezultateve të pranueshme të të mësuarit në përputhje me standardet ndërlombëtare në të gjitha nivelet e arsimit.....	20
Qëllimi 4: Inkurajimi i prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi për të mbështetur arsimin special.....	21
Qëllimi 5: Trajnimi i mësimitdhënësve për arsimin special	22
Qëllimi 6: Adaptimi i planprogramit të shkollës	22
Qëllimi 7: Pedagogjia	25
Qëllimi 8: Informimi i publikut për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin arsimor	27
Rekomandimet.....	27
KONKLUDIMI	29
Rast studimi 1 : Një vajzë 8-vjeçare me sindromin e Daunit në Prizren	29
Rast Studimi Dy: Djalë 12-vjeçar më dëmtime në të parë në Pejë	30
RAPORTI I SINTEZËS	31
Hyrje	33
Korniza ligjore	34
Pasqyre e politikës duke u fokusuar në grupet speciale.....	35
Statistikat dhe indikatorët	38

Trajnimi i mësimdhënësve.....	39
Trajnimi për profesionistët tjerë.....	40
Prindërit	40
Pedagogjia.....	40
Planprogrami.....	41
Organizimi i shkollës	41